

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7347 E mërkurë 8 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Titullin e këtij shkrimi e kam të konvertuar nga tregimi i Ismail Kadaresë, "Strategët e kafeneve", pasi profetët e sotëm të kafeneve u ngjajnë shumë strategëve...
Vijon në faqen 20

Nga SULEJMAN MATO

Profetët e kafeneve



Opinion i Ditës

Të hapen shkolla riedukimi për të rinj që abuzojnë me lëndët narkotike dhe kanë tendencë të kthehen në hajdutë dhe vrasës, ndryshe ky vend...
Vijon në faqen 21

Nga ZOJE JAKAJ

Shkolla riedukimi në vend të burgut



Lista me 1500 përfituesit nga e gjithë Shqipëria

"Ish-pronarët që kanë aplikuar në 1995-n, një muaj afat për dosjet"

Agjencia e Trajtimit të Pronave, apel: Futeni në fondin e kompensimit këtë vit, nëse plotësoni dokumentacionin që ju mungon

Nga ORNELA MANJANI

Janë rreth 1500 dosje ish-pronarësh që presin kompensimin nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, por që nuk kanë plotësuar gjithë dokumentacionin në përputhje me ligjin për trajtimin e pronës. Agjencia u ...
Në faqet 17-19

INTERVISTA II/ FLET BLENDAR NAÇI, OFICERI I ANTIDROGES I DEKORUAR NGA TAHIRI

"FIERI, BAZE TRANSITI PER HEROINEN E AFGANISTANIT"

"Droga, ka grupe më të fuqishme se Habilajt me lidhje politike. Trafikanti na tha 'përgjimet që keni në zyrë, i dëgjoj në shtëpi'. Incidenti me policinë e Vlorës"



(Në foto) Ish-efektivi i Antidrogës së Fierit, Bledar Naçi



REAGIMET POLITIKE

Prokuroria nis hetimin pasuror për Tahirin dhe familjen e tij

Në faqen 6

U DENUA 25 VITE

Gjykata liron nga burgu Genc Tafilin, Presidenti Meta e prokuroria: Të hetohen

Në faqen 9

DEBATET NE KOMISION

Ahmetaj: Taksim progresiv për çdo të ardhur, preken 1500 të punësuar

Në faqen 8

"VIP PAGES"

Fjolla Morina gjen të dashur të ri në Tiranë, detajet e lidhjes së re

Suplement

KONOMI: N JOHURI TE NEVOJSHME E AKADEMIKE



"Luarasi" hap master "Për sigurinë e rendin publik", dekania: Ka shumë interes

Në faqen 11

Agjentët e FBI në Tiranë, kush janë 6 ekspertët e Task Forcës. Xhafaj: Do shkatërrojmë krimin

Donald Lu: 2018-ta të nisë me arrestimin e 'peshqve të mëdhenj'

Vlahutin: Ne nuk bëjmë punën tuaj, të mos ketë të paprekshëm. Reagoni!

Nga DARINA TANUSHI

Ambasadori i SHBA-ve në Tiranë, Donald Lu tha qartë dje se në fillim të vitit që vjen duhet të arrestohen "peshqit e mëdhenj". Gjatë fjalës që mbajti në aktivitetin për prezantimin e operacionit "Forca e Ligjit", Lu u



shpreh se në Amerikë ka një shprehje që e përshatatur në shqip është "veprat flasin më shumë se fjalët". "Programi ynë për ndihmën ndaj policisë është përgatitur për të pasur një këshilltar ndërkom-bëtar, që do të punojë brenda kësaj Task Force ...

Në faqet 2-3

"FORCA E LIGJIT" OPERACIONI

Kryeministri: Do të fitojë Shqipëria e qytetarët

Rama: Lufta me krimin, jo lojë politike, duan të pengojnë drejtësinë

Kryeministri Edi Rama deklaroi dje se lufta me krimin nuk është lojë politike. Në një status të postuar në rrjetin social Facebook, kryeministri Edi Rama foli për prezantimin e operacionit policor "Forca e Ligjit". Prezantohet operacioni policor "Forca e Ligjit" dhe Task Force Speciale e Policisë së Shtetit kundër krimit të organizuar, e cila do të asistohet në terrenin e kësaj faze të re të luftës me krimin, nga agjentët e FBI dhe të disa agjencive prestigjioze kundër krimit në Gjermani, Itali dhe Britaninë e Madhe", shkroi dje Rama. Sipas tij, "Lufta me krimin nuk është lojë politike dhe mes qeverisë që



lufton krimin e atyre që luajnë politikisht e mediatisht me krimin për baltosjen e qeverisë, dallimi është i qartë: Nga lufta fiton Sh-

qipëria dhe njerëzit e zakonshëm të saj. Ndërsa nga loja ziejnë kazanët e politikës e të medias, që helmojnë pa pushim opinionin për hesape mizerabël, politike e financiare, por edhe për të penguar drejtësinë e re që po vjen". Gjatë komunikimit të së dielës që shkoi, kryeministri lajmëroi ardhjen në Shqipëri të agjentëve të FBI-së dhe krijimin e Task Forcës. Pasi njoftoi miratimin e kësaj Task Force me vendim qeverie, Rama tha të dielën se, "më mbush me optimizëm edhe përfshirja e agjentëve të FBI. Drejtori i

FBI dhe të dërguarit e tij vijnë këtë javë në Shqipëri. Me ambasadorin Lu nuk jam gjithmonë dakord çfarë thotë, por çfarë bën për Shqipërinë, po ashtu edhe qeverisë italiane dhe gjermane, që kanë sjellë të ekspertët e tyre për operacionin "Forca e Ligjit". Do të na bashkohen edhe agjentët e tjerë të FBI kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik, që do të japin eksperiencën e tyre në Shqipëri. Do të luftojmë me krimin e organizuar dhe krimin ekonomik", tha Rama.



Prezantohet operacioni "Forca e Ligjit", kush janë 6 ekspertët e huaj të Task Forcës

Agjentët e FBI-së në Tiranë, Xhafaj: Do shkatërrojmë krimin

"Do përdorim çdo mjet demokratik që të fitojmë këtë luftë"

Darina Tanushi

Ministria e Brendshme prezantoi dje edhe në prani të dy agjentëve të FBI-së, operacionin "Forca e Ligjit". Dy agjentët do të ndihmojnë Task Forcën për të luftuar grupet kriminale dhe asetet e tyre. Ata janë Mark Newhouse dhe Jack Liao. Mark Newhouse është agjent special i FBI-së dhe ka një përvojë të spikatur në drejtim të hetimit të krimit të organizuar dhe pastrimit të parave. Ndërsa Jack Liao është drejtuesi i FBI-së për Evropën Juglindore. Liao ka qenë në Tiranë më 10 korrik, kur është takuar edhe me kreun e Policisë së Shtetit, Haki Çako. Së bashku me agjentët e FBI-së në Shqipëri do të aistojnë edhe ekspertët të fushës nga Italia, Britania e Madhe dhe Gjermania. Dy agjentët u shfaqën dje pranë ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj dhe ambasadorëve Lu e Vlahutin, në aktivitetin ku



Ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj

u prezantuan pikërisht detajet e funksionimit të Task Forcës. Gjatë fjalës së tij, ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj tha se, "krimi, dhe për më tepër krimi i organizuar nuk ka markë shqiptare dhe as është emblema e shqiptarëve. Nuk jemi në të vetmit në këtë rajon dhe në këtë botë të trazuar, që e vuajmë këtë të keqe të madhe. Përkundrazi. Por, çësht-

ja shrohet se me gjithë progresin e bërë në këto 3-4 vitet e fundit në luftën kundër krimit të organizuar, ne jemi akoma larg standardit të një shoqërie, ku sundojnë ligji dhe drejtësia kudo dhe kurdoherë. Qeveria ka gjithë vullnetin, vendosmërinë dhe mekanizmat për t'u ballafaquar me këtë sfidë. Ndaj, ne sot po marrim përgjegjësinë për ta bërë këtë luftë me

vendosmëri, pa asnjë mëdyshje, pa asnjë dallim, për të bërë të mundur që forca e ligjit të triumfojë", u shpreh Xhafaj. "Mesazhi që dëshiroj të përcjell sot për qytetarët e vendit tim është i qartë: Krimi i organizuar nuk mundet dhe shumë shpejt nuk do të ketë të ardhme në Shqipëri", theksoi Xhafaj gjatë fjalës. Ai shtoi: "Ne jemi të vendosur të bëjmë gjithçka të

Pasuritë e sekuestruara, Faskaj: Kemi verifikuar grupet kriminale në vend

Ministria e Brendshme ka bërë publike detaje nga operacioni "Forca e Ligjit". Në këtë material thuhet se vetëm në 2017-ën janë identifikuar 358 mjete, 286 apartamente dhe banesa, 15 vila private, 7 komplekse shërbimesh, 87 lokale si dhe janë sekuestruar 35 milionë euro llogari bankare, 5 apartamente dhe 42 mijë m² tokë. Po ashtu, në material është sqaruar edhe struktura e punimeve për grupet kriminale, ku 53% lidhen me narkotizimin, 11% me trafiket e paligjshme, Krimet e rënda rezultojnë 18%, po aq sa edhe krimi ekonomik. Idajet Faska, drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimet e Rënda në Policinë e Shtetit u shpreh dje: "Është bërë verifikimi i të gjitha grupeve kriminale që operojnë në vend. Lufta kundër krimit të organizuar është prioritet i qeverisë dhe policisë. Policia është në një fazë që ka arritur sukses kundër kultivimit të kanabisit, por kjo nuk është e mjaftueshme nëse nuk do veprojmë kundër kriminalitetit, të financojmë paratë e fituara nga ky aktivitet në ekonominë e vendit", tha Faskaj. Më tej ai tha: "Jemi në fazën kur policia do përballlet me luftën kundër këtyre grupeve, me në krah dhe institucione të tjera. Task Forca do shtrihet në dy nivele, qendrore dhe rajonale, që do kenë oficerët e policisë gjyqësore, janë katër njësi hetimore. Njësi tjetër e rëndësishme është ajo e bashkëpunimit ndërkombëtar, pasi 40% e tyre janë të shtrirë dhe jashtë vendit. Ka specialistë që janë të gatshëm të kryejnë çdo lloj hetimi, duke bërë koordinimin me partnerët për shkëmbimin e informacionit. Në çdo drejtori vendore do ketë drejtues të njësisë, në koordinancë me Task Forcën qendrore, për të kryer të gjitha veprimet operacione dhe aksionet e përbashkëta për goditjen e krimit. Policia e Shtetit i ka kapacitetet e duhura për të përballur këtë sfidë", tha Faskaj.

mundur të shkatërrojmë rrjetet kriminale, infrastrukturën e tyre, të shkatërrojmë fuqinë e tyre ekonomike. Unë dhe qeveria ku bëj pjesë e kuptojmë shumë mirë këtë, ndaj ne do të bëjmë të pamundurën, do të përdorim çdo mjet demokratik që ta fitojmë këtë luftë me krimin e organizuar në Shqipëri", vijoi fjalën e tij, Xhafaj. Sipas tij, "grupet të

përbashkëta të personelit policor shqiptar me agjentët të spikatur të FBI dhe të shërbimeve policore anti-krim të Italisë, Gjermanisë, Britanisë së Madhe shumë shpejt do të prodhojnë rezultate sinjifikative në identifikimin dhe goditjen e anëtarëve, drejtuesve dhe asetëve, kudo qofshin të fshehura, të individëve apo organizatave kriminale".

NDËRKOMBËTARËT E ANTIKRIMIT

Agjenti special i FBI-së, **Mark Newhouse** Drejtuesi i FBI për Evropën Juglindore, **Jack Liao** **Hubertus Hoffmann**, ekspert i Zyrës Federale të Policisë Kriminale të Gjermanisë. **DO TË VIJË SË SHPEJTI** Koordinatorja e Drejtorisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda në Balikanin Perëndimor, në Ministrinë e Brendshme Britanike, Sarah McAveety. Dy ekspertë të posaçëm të Guardia di Finanza dhe Interforza



Dy ekspertët e FBI-së gjatë prezantimit të operacionit "Forca e Ligjit"

Ambasadorët e SHBA e BE kërkojnë reagimin e autoriteteve shqiptare

Donald Lu: Viti 2018 të nisë me arrestimin e 'peshqve të mëdhenj'

Vlahutin: Ne nuk bëjmë punën tuaj, të mos ketë të paprekshëm

Darina Tanushi

Ambasadori i SHBA-ve në Tiranë, Donald Lu tha qartë dje se në fillim të vitit që vjen duhet të arrestohen "peshqit e mëdhenj". Gjatë fjalës që mbajti në aktivitetin për prezantimin e operacionit "Forca e Ligjit", Lu u shpreh se në Amerikë ka një shprehje që e përshtatur në shqip është "veprat flasin më shumë se fjalët". "Programi ynë për ndihmën ndaj policisë është përgatitur për të pasur një këshilltar ndërkombëtar, që do të punojë brenda kësaj Task Force ndërinstitucionale. Ndihma jonë për prokurorinë dhe policinë do të mbështesë zhvillimin e institucioneve të reja në luftën kundër krimit të organizuar, SPAK-un dhe BKH-në. Gjithashtu, kemi edhe një agjent të ri special të FBI-së, i specializuar në krimin dhe organizuar transkombëtar, i cili do të punojë në Tiranë për disa muaj në mbështetje të kësaj përpjekjeje. Po flasim me vepra dhe jo me fjalë", tha Lu. "Ne në Amerikë kemi edhe një shprehje tjetër - 'dreka falas nuk ekziston'. Nëse Amerika dhe vendet e BE-së do të vendosin burimet dhe besueshmërinë tonë në këtë luftë kundër krimit të organizuar, ne presim rezultate. Çfarë presim? Presim që ky plan agresiv i qeverisë së Shqipërisë të përfundojë me arrestimin dhe ndjekjen penale të disa 'peshqve të mëdhenj' në fillim të vitit të ardhshëm dhe që ky sukses të vazhdojë në vitin 2018 me SPAK-un dhe BKH-në", theksoi Lu. Sipas tij, këtë e presin partnerët ndërkombëtarë të Shqipërisë, ndërsa populli shqiptar e meriton. "Ajo që dimë gjithashtu është se Shqipëria ka një problem me lidhjen mes grupeve kriminale dhe politikanëve. Nëse e mohoni këtë, ju lutem të shqyrtoni rastet e Arben Ndokës, Mark Frrokut, Gentian Muhametit dhe Elvis Rroshit", tha Lu duke folur qartë. Sipas tij, "ky nuk është problem i vetëm një partie, ky është një problem që ka pllakosur politikën shqiptare që nga rënia e komunizmit. Populli shqiptar ka fjalën tonë se Shtetet e Bashkuara do të angazhohen fuqishëm kundër krimit të organizuar, pavarësisht lidhjeve që mund të ketë me njëri-tjetër të fuqishëm,



Ambasadori i SHBA-së, Tiranë, Donald Lu



Ambasadorja e BE-së, në Tiranë, Romana Vlahutin

ARBEN NDOKA

Unë nuk di të jem akuzuar për krime politike apo vepra të tjera penale, që kanë qenë në dëm të parlamentit ku isha pjesë, as në dëm të politikës, as të Shqipërisë, e as të askujt. Doja të vazhdoja jetën time, por mesa duket po më vënë kusure që nuk më përkasin. Uroj vërtetë të bëhet drejtësi, por me kriminelët e vërtetë ama, një sërë të cilës unë nuk i përkasim, tha dje Ndoka.



Paloka: Edi Rama është 'peshku i madh' në Shqipëri

Deputeti i Partisë Demokratike, Edi Paloka ka komentuar deklaratën e ambasadorit Donald Lu lidhur me 'peshqit e mëdhenj' që duhen arrestuar. Në një postim në faqen e tij të "Facebook"-ut, Paloka pohon se 'peshku' më i madh, i zhytur me krimin është kryeministri Edi Rama. "Peshq të vegjël, peshq të mëdhenj". Kush ha e kush do ta hajë? Unë nuk mund të ç'kodifikoj kodet e askujt, po unë dhe gjithë shqiptarët dimë shumë mirë se 'peshku i madh' i krimit në Shqipëri është një dhe vetëm një e quhet Edvin Kristaq Rama", u shpreh dje deputeti demokrat në reagimin e tij, menjëherë pas deklaratave të ambasadorit amerikan, Donald Lu. "Sa të vazhdojë të jetë ai kryeministër një vit, një muaj, një javë, një ditë apo dhe një orë, krimi në Shqipëri do vazhdojë vetëm të rritet e fuqizohet", e mbylli komentin e tij deputeti demokrat. Çdo ditë në deklaratat e tyre demokratët fajësojnë kryeministrin Rama për lidhje me krimin dhe bandat.



Operacioni antikrim, Vasilij: Janë dëngla të Ramës, ai pengon hetimin

Pas prezantimit të operacionit "Forca e Ligjit" dhe Task Force Speciale e Policisë së Shtetit kundër Krimit të Organizuar" sot nga qeveria "Rama", kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasilij, ka reaguar. Me anë një postimi në "Facebook" Vasilij shkroi se kryeministri Rama është "përdorues dhe frymëzues i kazarit të krimit, dënglat e tij janë lojë". "Kryeministri është përdorues dhe frymëzues i kazarit të krimit, dënglat e tij janë lojë. Kryeministri riciklon kazarët e krimit dhe nuk i lufton ato. Kryeministri e përdor krimin, i jep vetes kurajë me kriminelët, nuk ka as guximin më të vogël të ndryshojë dot asnjë nga ata në polici, që e bënë krimin epidemik", u shpreh dje Vasilij. Sipas tij, Rama "e pengon krimin të hetohet siç bëri me ish-ministrin, e përmbysi vendin me drogë e trafikantë. Ky është thjesht kryeministër i kazarit të krimit, përdorues dhe frymëzues i tij, këtë e di edhe njeriu më i zakonshëm", e mbylli postimin e tij Vasilij. "Dënglat dhe ilfazandilëqet historike janë lojë, edhe kjo në favor të krimit", shtoi kreu i grupit të LSI-së.

Ministri britanik: 'Peshqit e mëdhenj' të mos dalin nga rrjeta

Duncan: Hetoni urgjent bandat kriminale, s'kanë pikë mëshire

Ministri i Shtetit në Britani për Evropën dhe Amerikën, Sir Alan Duncan, i bëri thirrje Shqipërisë të hetojë bandat kriminale. Në prezantimin e operacionit "Forca e Ligjit", ministri britanik deklaroi se kriminelët nuk tregojnë pikë mëshire ndaj më të dobëtëve, ndaj dhe duhen hetuar e ndaluar. Ai premtoi mbështetjen e Britanisë, nëse Shqipëria e merr seriozisht luftën ndaj krimit. "Krimi i organizuar është një plagë që duhet ta luftojmë, pasi na infektionon këtu në Shqipëri e deri në Britani. Grupet kriminale shfrytëzojnë dobësinë



në zbatimin e ligjit. Ata nuk tregojnë pikë mëshire ndaj më të dobëtëve, ndaj duhet të punojmë së bashku dhe vlerësoj shumë praninë sot të 3 ministrave të qeverisë shqiptare, që tregojnë vendosmërinë për të luftuar krimin. Sh-

qipëria ka treguar me vepimet e saj kundër kanabisit se ç'mund të arrijë me vullnetin politik, pra se mund të arrijë gjithçka dhe duhet të ketë një fund në lidhje me mosndëshkueshmërinë, pasi 'peshqit e mëdhenj' duhet të kapen, nuk duhet të dalin nga rrjeta. Nëse individë të tillë ndiqen penalisht dhe dënohen, ky do të jetë një mesazh i qartë se Shqipëria e ka seriozisht luftën lundër krimit të organizuar", tha Sir Alan Duncan. Më pas, ministri britanik zhvilloi një takim me ministrin e Jashtëm shqiptar, Ditmir Bushati.

përfshirë politikanë, gjykatës, prokurorë apo biznesmenë të fuqishëm. Asnjë nuk është mbi ligjin. Në shqip ju thonin: 'Peshku i madh e ha të voglin'. Për një herë të vetme në Shqipëri, le të hamë 'peshkun e madh'".

AMBASADORJA E BE

Ndërsa gjatë fjalës së saj, ambasadorja e BE-së në Tiranë, Romana Vlahutin tha se shqiptarëve u kishte ardhur në majë të hundës me situatën e krijuar në vend. "U kishin ardhur në majë të hundës dekada arrogancë të grupeve të interesit të korruptuara dhe të kriminalizuara, që besojnë se Shqipëria ekziston për t'i bërë

ata të pasur dhe se ata nuk i detyrohen për asgjë shtetit dhe popullit, që i quajnë të vetët. Një mik shumë i mirë shqiptar më ka thënë se si vëllai i gjyshit nga babai, që kishte studiuar fizikë në Francë dhe ishte studiues i madh, thoshte: 'Bir, në të kaluarën njerëzit i shinin shtëpitë për atdheun, tani shinin atdheun për shtëpinë e tyre", tha Vlahutin. Por, sipas saj, këta janë të paktët që nuk kanë turp, moral dhe respekt për vendin që u dha atyre jetë. "Kemi kaluar tre vite mjaft të vështira për të bërë të mundur që një reformë e thellë e drejtësisë të shtrojë udhën për institu-

cionet e reja, që do të njohin vetëm një pushtet dhe vetëm një sundues, ligjin, që është i barabartë për të gjithë. Jo të paprekshëm, jo nga ata që e blejnë drejtësinë apo abuzojnë me të me një telefonatë", tha Vlahutin. "Ne të komunitetit ndërkombëtar nuk jemi policë, nuk jemi prokurorë apo gjyqtarë. Ne nuk mund të bëjmë punën tuaj, por jemi aleatët tuaj dhe partnerët tuaj në këtë luftë dhe do të bëjmë sa mundemi për t'ju ndihmuar ta bëni si duhet punën tuaj. Ju duhet të tregoni rezultate konkrete, të prekshe dhe të pakthyeshme", u shpreh ambasadorja.

TRAFIKU I DROGES

INTERVISTA

Oficeri i Antidrogës rrëfen incidentin Shoqëruesi i skafit na tha: Ju fus plumbin

Bledar Naçi: Bllokuam skafin, por policët e Vlorës na treguan armët

"E dërguam në komisariat, por pas një ore u zhduk"

Basir Çollaku

Bledar Naçi është ish-oficer i Antidrogës, dikur i dekoruar nga Saimir Tahiri dhe i përgëzuar nga Edi Rama për "heroizëm" dhe sot, i detyruar të strehohet nga përndjekja e shtetit që i shërbeu për shumë vite. Njësoj si Dritan Zagani dhe Antonio Nazeraj, jeta e Bledar Naçit mori tatëpjetën kur u përplas me grupin e Habilajve që udhëtonin me makinën e ish-ministrit të Brendshëm, në fund të vitit 2013.

Dje, në pjesën e parë të intervistës për "Gazetën Shqiptare", ish-efektivi i Antidrogës së Fierit rrëfue detajet e shoqërimit të vëllezërve Habilaj dhe lirimin e tyre me urdhrin e drejtorit të policisë. Pas këtij incidenti, njësoj si shokët e tij Naçi u akuzua se i kishte marrë 10 mijë lekë të reja një personi që sot rezultoi i dënuar për disa vepra penale.

"Gazeta Shqiptare" ju sjell sot pjesën e dytë të intervistës me ish-efektivin e policisë, Bledar Naçi (sot ndodhet në një vend të BE) ku ai flet për trafikun e heroinës dhe kokainës. Naçi tregon dy incidente: 1 pari, kur sekuestruan 3.5 kg heroinë dhe "1 zoti i mallit" i kërcënoi duke thënë se "Përgjimet që ju i dëgjoni në zyrë, mua mi sjellin nga Tirana dhe i kam në shtëpi".

Dhe incidenti tjetër, kur ai dhe Zagani ndaluan një skaf të dyshuar për trafik dhe policia e Vlorës u përplas me ta me armë, pasi nuk lejonte sekuestrimin e skafit.

(vijon nga numri i djeshëm)

Pastaj erdhi arrestimi, burgosja dhe dënimi?

Jam arrestuar me datë 2 maj 2014, dhe jam liruar nga burgu me datë 14 janar të vitit 2015

Jeni pyetur ndonjëherë gjatë qëndrimit në burg?

Jo, gjatë qëndrimit në burg nuk jam pyetur asnjëherë. Pas disa muajsh më ka ardhur në qeli shefi i SHKB Fierit, duke më paraqitur një shkresë ku më kërkohet të firmosja mbylljen e hetimeve, se nuk ishin gjetur prova për të vazhduar hetimet më tej. Ishte ky person që më ka ardhur dhe më mëdjet e burgut të Vlorës. Nuk jam pyetur asnjëherë nga prokuroria

Jeni dënuar pastaj?

Jam dënuar dy vjet me shërbim prove. Pas daljes nga burgu jam larguar nga Shqipëria pas disa muajsh.

Perse, ishit i pasigurtë, kishit kërcënime?

Kërcënimet ndaj meje jashtë burgut kanë rrjedhojë dhe ato që janë bërë gjatë qëndrimit në burg. Kjo ka ndodhur dhe në burg

Si?

Mund ta verifikoni. Në burgun e Vlorës kam ndenjur në qeli me persona që ishin të dënuar me 25 vjet për vrasje,



Ish-efektivi i Antidrogës së Fierit, Bledar Naçi

Në qeli të dënuar ka..?

Po e di këtë, kam qenë në dhomë me persona që kanë qenë të dënuar për vrasje, për grabitje me armë dhe për pengmarrje, jam kërcënuar dhe nga të dënuar të tjerë.

Keni denoncuar?

Jam goditur brenda në burg

Si goditur?

Po më kanë qëlluar të burgosur, duke më thënë se ti u ke bërë shumë keq miqve dhe shokëve tanë, gjatë kohës që ke punuar në polici, sidomos kohët e fundit. Jam masakruar, sepse një moment kam qenë vetëm dhe jam qëlluar, më kanë thyer dhembët e nofullës së sipërme, në burgun e Vlorës.

Ju nuk e keni denoncuar?

Ku ta denoncoj. Jam këshilluar dhe jam mbyllur në qeli, sepse këto gjëra mund të nisin si sherr banale dhe mund të ishte fort mirë një tentativë ekzekutimi ndaj meje dhe kam shpëtuar për fat të ndërhyrjes së disa punonjësve të burgut që u ndodhën dhe hynë me shpejtësi. Kanosja ka vijuar edhe pas daljes nga burgu, kanë ardhur mesazhe direkt dhe indirekt, në lagjen time dhe në banesën time

Ju i keni denoncuar?

Ju pyesni a i kam denoncuar? Te cila polici? Te ajo e Fierit, që mua më futi brenda në atë mënyrë, te ata drejtues policie që kishin ato lidhje dhe njohje, ajo polici do më jepte garanci për jetën time.!!!

Ju keni punuar gjatë në polici, sipas informacioneve tuaja, cili është aktiviteti i grupeve kriminale në qarkun e Fierit, Vlorës, po të këtyre zonave?

Aktiviteti i tyre, është shumë i organizuar, jo vetëm në kultivimin e hashashit dhe janë të shtrirë dhe në trafikun e heroinës dhe të kokainës. Janë aq të organizuar sa nuk mund t'u ofroresh dot. Janë shumë të organizuar sa policia këtyre grupeve, nuk mund t'u ofrohet dot.

Po nëse nuk i ofrohet policia kush mund ta bëjë?

Po ta them edhe një herë, policia këtyre grupeve nuk mund t'u ofrohet dot. Policia u ofrohet atyre, po të ketë drejtues policie që nuk janë të lidhur me to.

Kjo është akuzë, e keni të mbështetur në informacione?

Kjo është e vërtetë nuk është akuzë. Dhe unë mund t'ua shpjegoj konkretisht.

Po.

Gjatë muajit dhjetor 2013, seksioni Antidrogës, ku kam qenë edhe unë pjesë, ka bërë një kapje sasie heroinë, 3.5 kilogramë, e pastër dhe ky person është arrestuar e ka shkuar në burg dhe droga është sekuestruar. Gjatë hetimeve që kemi pasur na kanë dalë në lidhje me të, me numra telefonash persona që kanë biznese shumë të fuqishme në Fier.

Të kesh një numër, nuk e fajëson një person?

Këtë dua të shpjegoj. Nga hetimi këtij personi kanë dalë numra telefonash të këtyre bizneseve të personave që ne kishim në hetim, personave që kanë biznese në Fier, po flas për biznese të mëdha dhe jo për lokale e dyqane lagjesh. Dhe unë jam kërcënuar edhe nga ky person për të cilin po flasim, unë edhe ish-kolegu im Antonio Nazeraj.

Perse?

Sepse ky person ishte në ndjekje dhe në hetim nga ana jonë. Kjo çështje nuk bënte fjalë vetëm për 3.5 kilogramë, ishte akoma edhe më e madhe. Gjatë hetimit kemi marrë shumë informacione për adresat, për numra telefonash, informacione që përcillen tek të gjithë eprorët deri të drejtorit, me numra telefonash, me automjetet që kanë dhe lëvizin me to, adresat e banesave dhe numrat e telefonave që këta i ndërronin herë pas herë qëllonte gjithnjë që ne na dilnin të fikur. Këto info janë të përcjella në rrugë zyrtare tek eprorët tanë.

Por pastaj si vepruat me këtë hetim?

Gjatë kohës, që ky person dhe shumë persona të tjerë ishin nën hetim, vjen ky per-



son dhe unë isha me kolegun tim Antoni Nazeraj dhe kërkon, na vjen aty ku ishim, kërkon të flasë me ne. Urdhëro i themi, çfarë ke për të thënë?

Dhe çfarë ju tha..?

Atë emrin tim tha mos e përmendni më, sepse ju e keni të kotë, mos shkruani më për mua, sepse ato disqet e përgjimeve të bisedave që dëgjoni ju në zyrë, unë i dëgjoj në shtëpi dhe unë i marr të gatshme nga Tirana. Kështu na tha mos u merrni me mua, merrni me të tjerë, e kjo për ne ishte një kanosje e hapur për shkak të detyrës, se mund t'ia kalojmë mirë bashkë, por edhe mund të mos ia kalojmë mirë. Ky person bashkëpunonte dhe me grupe të tjera.

Sa grupe të tjera kishte..?

Mund t'ju them se ky grup i fuqishëm kriminal kishte lidhje dhe me grupe në Vlorë dhe ka pasur lidhje të fuqishme edhe në politike, njëkohësisht kishte lidhje të forta edhe me Habilajt, këto informacione ne i kishim zyrtare, ishte grup paralele me Habilajt, por shumë më i fortë se ai.

I keni zyrtare këto informacione?

Sigurisht që i kemi bërë zyrtarisht dhe janë arkivuar, nëse këto i kanë hequr, atëherë kjo është punë tjetër.

Keni pasur bashkëpunim apo përplasje në luftën kundër trafikut?

Ne kemi pasur përplasje edhe me policinë e Vlorës në operacione kundër trafikut dhe për këtë mund t'ju tregoj një rast konkret.

Cilil rast?

Kemi qenë në një shërbim në Lushnjë, së bashku me shefin e sektorit Dritan Zagan, se kemi qëndruar disa ditë dhe kemi pasur rezultate në kapjen e narkotikëve. Një ditë, na është dhënë urdhrë nga eprorët që kishin një informacion për një skaf në zonën e Levanit dhe kemi shkuar unë dhe Zagani. Gjatë rrugës Zagani komunikonte herë pas herë me shefin dhe informohej për detajet gjatë operacionit, informohej salla nga inspektori, dhe kështu zinxhir na vinte informacioni.

Çfarë mjeti ishte ai që po ndiqnit?

Ishte një land Rover që po tërhiqte skafin për ta zhvendosur dhe po kalonte territorin e qarkut Fier, kishte mbërritur te ura e Mifolit. Ka qenë një këmbëngulje e Zagani dhe e shefit që komunikonte dhe na u tha ta ndiqnin deri në destinacion që ta ndalonim, ndonëse kishte hyrë në zonën e Vlorës, duhej të përfundonim operacione



← nin dhe unë dhe Zaganin kemi vijuar ndjekjen dhe e kemi ndaluar mjetin Çfarë bëte?

Kemi kërkuar dokumentacionin e mjetit, ishte skaf me tre motorë, shefi bënte komunikimin dhe unë isha mbështetës. Është kërkuar dokumentacioni, është kërkuar shpjegim nga poseduesi i mjetit, përse ke dalë në këtë periudhë, për çfarë arsye dhe ne kishim infot e inspektorit. Në këto momente që në po kërkonim shpjegimet ndaj këtij personi, nga na e shefit, në këto çaste mbërrijnë oficerët të policisë së Vlorës, katër persona, dy prej të cilëve i njihja se ishin oficerë policie.

Ata ju mbështetën ju?

Kanë debatuar me Zaganin, ne donim që mjeti të shoqërohej në Fier, gjatë kësaj kohë Zaganin ka komunikuar me shefin duke kërkuar forca të tjera të mbështesnin operacionin dhe ishim në pritje të ardhjes së forcave

Si ndodhi?

Dhe oficerët e Vlorës na thanë se ju nuk keni të drejtë, Zaganin bisedoi me to dhe ata na thanë se jemi informuar nga salla operative se në rrugë është një skaf.

Ju s'besoni?

Jo unë besoj se janë lajmëruar nga personi që kishte skafin. Duke pritur forcat ata na thanë se jemi të Triportit dhe vetëm ne kemi të drejtë të bëjmë verifikim

E latë?

Zaganin ka debatuar me këta persona, flas me ata që unë i njoh, që nuk kanë pranuar dhe donim me çdo kusht mjeti të shkonte në Vlorë dhe jo në Fier se ne jemi ekspertë. Zaganin tha se ne do marrim e shoqërojmë mjetin, shef Zaganin si ish-shef i Kufirit dhe njohës i mirë i ligjeve dhe procedurave u bëri të ditur atyre se po respektonin ligjin dhe ky debat u bë i nxehtë

Si?

U arrit deri në fyerje dhe nxjerrje armesh... Nxjerrje armësh?

Po, në vend të na ndihmonin, ata këmbëngulnin në të tyren për të marrë mjetin dhe ne nuk jemi mbështetur nga policia e Vlorës në këtë operacion për të sekuestruar këtë skaf me tre motorë, policia e Vlorës është bërë pengesë, duke kërkuar me çdo kusht marrjen e mjetit

Si vajti..?

Nga ato kishte dhe persona të tjerë që po

I dekoruari nga Tahiri: Ka grupe më të fuqishme se Habilajt me lidhje politike

Oficeri i Antidrogës: Fieri, bazë transiti për heroinën e Afganistanit

Bledar Naçi: Kapëm 3.5 kg drogë, na kërcënuan. Personi na tha: Përgjimet që keni në zyrë, unë i dëgjoj në shtëpi

afroreshin dhe në ndërkohë në prisim forcat tona dhe ne ishim në këto momente në rrethik, kur ka ardhur patrulla e policisë dhe personi që kishte mjetin na kërcënuar mua dhe Zaganin duke na thënë se për këtë që po bëni do t'ju fus plumbin dhe ka shfrytëzuar situatën e debatit për t'u larguar.

Kush e mori mjetin?

Mjeti është marrë me forcë nga ne, janë marrë çelësat e mjetit, ndërkohë që erdhën dhe forcat tona mbështetëse. Personi në ikje e sipër na kërcënoi, Zaganin dhe mua, duke thënë se për këtë do ju fus plumbin, dhe u largua ndërkohë që oficerët e Vlorës e lejuan të ikte dhe nuk bënë asgjë.

E morët skafin dhe e dërguat në Fier?

Po skafi është marrë nga ne dhe është dërguar në drejtorinë Fierit dhe ka qëndruar një orë aty.

Si një orë...?!!

Ka qëndruar rreth një orë, jo më shumë se një orë, para drejtorisë së policisë së Fierit dhe e kanë marrë dhe është larguar.

Hollivood?

Ashtu mund të duket. Por nuk jam vetëm unë dëshmitar në këtë ngjarje. Nuk di si e kanë bërë dokumentacionin dhe kanë urdhëruar nga larg, por skafi menjëherë është larguar, nuk di kush ka urdhëruar nga lart që ka ndodhur kjo, po të them këtë që di.

Është bërë informacion?

Sigurisht është bërë informacion nga inspektorët i zonës, është bërë raport shërbimi dhe është kërkuar nga shefat, dhe informacionit të tij i është bashkëngjitur informacioni ynë dhe është përcjellë për në drejtori lart.

Skafin e kanë marrë?

Jo e kanë marrë se nuk është grabitur, skafin është urdhëruar që ta largojnë ta marrë dikush, me gjithë makinë, fuoristrada me gjithë karrel

Trafiku i heroinës e kokainës ka pasur zgjerim këto vite, Habilajt thatë bashkëpunonin me grupe të tjera, kishte grupe më të forta se ky grup thatë?

Ka pasur grup të tjera dhe ka ende grupe në Fier, ekzistojnë janë të lidhur me njëri-tjetrin. Janë të lidhura. Nuk kanë targa grupet, targa Fieri apo Vlora, ka pasur dhe ka ende grupe shumë më të fuqishme se Habilajt, por këta hapnin rrugën. Këto grupe kanë pasur dhe kanë mbështetje politike. Kam info të sigurta. Vitet e fundit është fuqizuar akoma më shumë. Ka grupe në Fier që nuk mund të blesh një kilogram apo dy kilogramë, ata nuk shesin më pak se 10 kile kokainë, por nuk kanë dashur të hetohen.

Kjo nuk është supermarket..?

Jo nuk është ashtu, por ka grupe që shesin me shumicë, janë dora e parë e trafikut dhe nuk japin me kilogramë, por me 10 kilogramë e lart.

Ku e dërgojnë?

Në Evropë, kryesisht në Itali, heroina vjen nga Afganistani, kokaina nga Amerika Latine por edhe Holanda.

Fieri ka grupe që nuk mund t'u ofroresh dot edhe sot e kësaj dite që në flasin. Nuk i ofroresh dot

Kush i mbron?



3

OFICERE POLICIE "TE PERNDJEKUR"

Bledar Naçi është i treti efektivi policie që u përndoq në Shqipëri pasi guxoi të përplasej me kushërinjtë e ish-ministrit të Brendshëm. Në fillim ishte Dritan Zaganin, i cili denoncoi lëvizjet e "Audit" famëkeq tek eprorët e tij. Zaganin u akuzua se "i shiti" informacion italianëve. I dyti, Antonio Nazeraj, efektivi i Antidrogës, pjesë e "postbllokut të Levanit" që ndaloi Habilajt, u arrestua nga SHKB dhe më pas u lirua. I treti, Bledar Naçi u vu nën vëzhgim nga SHKB, u arrestua dhe u lirua.

Policia nuk u ofrohet se janë drejtuesit që janë të lidhen, një oficer antidroge, një polic i thjeshtë është gjithnjë i rrezikuar dhe i shitur dhe në jo pak raste ne kemi qenë të dekonspiruar dhe të shitur. Kjo na ka ndodhur.

Informacionet që bëj unë dhe kolegët përcillen më lart te eprorët nga shefat e seksionit dhe sektorit nuk kemi qenë asnjëherë të tradhtuar, sepse ne kemi bërë shumë shpesh info të përbashkëta, ku kemi firmosur bashkërisht në këto dokumentacione shkresa, raporte shërbimi, kur informacioni shkente lart në drejtori e drejtorinë e përgjithshme, atëherë në shpesh ishim të zbuluar

Ka pasur probleme përveç drogës edhe me kontrabandën?

Kontrabanda e naftës nuk ka qenë problem vetëm këto vitet e fundit, por gjithnjë, ndonëse është shtuar së fundmi. Ka pasur dhe më herët kur janë sekuestruar autobote dhe ngarkesa të shumta nga shumë sektorë të drejtorisë. Kemi marrë pjesë në disa operacione dhe ka pasur edhe arrestime e bllokime edhe para vitit 2013. Pas këtij viti, u shtua kjo kontrabandë dhe jepej leja hapur për ta bërë këtë.

Policia u bë si ndërmarrje private që jepte licencë

Si jepte licencë?

Po, po jepte "leje" për të hapur lokale për prostitucion, i lejonin duke ushtruar këtë aktivitet dhe i mbronin këtë unë e faktoj me raste konkrete, sepse kemi bërë arrestime dhe sekuestrime e bllokime lokale në hotele e motele, sigurisht kjo është paligjshme, por kupola e policisë jepte këto lloje "licensash"

Dhe nafta?

Sigurisht dhe kontrabanda e naftës bëhej me leje të policisë, se ata jepnin leje për kontrabandën e naftës dhe solarit, sepse ishin persona që kishin marrë leje ta bënin këtë. Persona të caktuar që e bënin këtë punë, ishte e organizuar. Sepse policia drejtuesit e saj hapnin rrugën. Ata merrnin paratë dhe hapnin rrugën dhe personat nuk kontrolltoheshin, janë arrestuar dhe janë nxjerrë jashtë dhe janë arrestuar gabimisht.

Ka raste kur shoferi i drejtorit ka marrë botet e ndaluar dhe i ka nxjerrë jashtë komisarariat.

Policia qenka vetëm si godinë aty?

Nuk e di si është tani, por atëherë ashtu ka qenë katandisur

I provoni këto që thonë, ia ofroni dëshminë tuaj prokurorisë, dëshmoni serish para saj?

Jam i gatshëm në çdo moment nëse do të ketë drejtësi, momentalisht nuk besoj, sepse nuk ka drejtësi...

DOSJA 'TAHIRI' REAGIMET

Ish-ministri i Brendshëm nën akuzë për trafik droge e korrupsion pasiv

Prokuroria nis hetimin pasuror për Saimir Tahirin dhe familjarët e tij

Në "sitë" pasuritë e paluajtshme e llogaritë bankare

Ina Allkanjari

Ish-ministri i Brendshëm Saimir Tahiri do të jetë tashmë subjekt i ligjit për hetimin pasuror. Ndaj tij prokuroria ka ngritur akuzën e trafikut të drogës në formën e grupit të strukturuar kriminal dhe korrupsionit pasiv. Këto dy vepra penale bëjnë që ndaj ish-ministrit të Brendshëm të nisë verifikimi mbi pasuritë që disponon. Njësi Antikorrupsion pranë Prokurorisë për Krimet e Rënda ka nisur hetimin pasuror edhe ndaj Orest Sotës, vëllezërve Habilaj dhe personave të tjerë të implikuar nga në këtë dosje. Në këtë hetim do të përfshihen edhe familjarët e Tahirit, për të cilët pritet të verifikohen pasuritë e paluajtshme e llogaritë bankare, për të mësuar nëse ata i justifikojnë apo jo këto pasuri. Ndërkohë ende nuk ka një konfirmim zyrtar nëse çështja e biznesmenit Sota, do t'i bashkohet dosjes së Tahirit. Për sa i përket gjetjes së patentave të ish-ministrit të Brendshëm në makinën e shtetasit Orest Sota, sipas prokurorisë deri më tani nuk përbën veprë penale.

HETIMI I PROKURORISË

Ish-ministri i Brendshëm Saimir Tahiri akuzohet nga prokuroria për trafik të lëndëve narkotike të kryer në bashkëpunim. Kërkesa zyrtare e Prokurorisë së Përgjithshme për heqjen e imunitetit, arrestimin dhe kontrollin e banesës së ish-ministrit Saimir Tahiri mbështetet sipas prokurorisë në përgjimet telefonike të dyshuarve Habilaj si dhe në faktin që Tahiri ka udhëtuar me të dyshuarin Artan Habilaj dhe persona të tjerë me makinën që ai më herët ua kishte shitur të dyshuarve. "Si rezultat



Ish-ministri i Brendshëm Saimir Tahiri


HETIMI PASUROR

Në hetim pasuror do të përfshihen edhe familjarët e ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri, për të cilët pritet të verifikohen pasuritë e paluajtshme e llogaritë bankare, për të mësuar nëse ata i justifikojnë apo jo këto pasuri.

Nga familja e biznesmenit ende asnjë provë në prokurori

U kap me 863 mijë euro, dosja e Orest Sotës kalon të Krimet e Rënda

Prokuroria e Elbasanit shpalli moskompetencë për hetimin e biznesmenit Orest Sota, të arrestuar disa ditë më parë. Dosja e biznesmenit ka mbërritur mëngjesin e djeshëm në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Sota duhet të vërtojë burimin e ligjshëm të 863 mijë eurove që iu gjetën në makinë, ndërsa për sa i përket çështjes së patentave që iu gjetën në automjet, sipas prokurorisë, nuk përbën veprë penale. Hetimi pasuror për çështjen e biznes-



menit i kalon njësisë Antikorrupsion të Krimeve të Rënda. Brenda 9 ditëve Orest Sota pritet të dalë para

gjykatës së Krimeve për të rikonfirmuar masën e arrestit me burg nga gjykata kompetente. Ndërkohë i arrestuari Oresti Sota dhe babai i tij Lefter Sota, pretendojnë se sasia e parave buron nga të ardhurat personale dhe kursimet në vite dhe do të përdorëshin për blerjen e hekurit të kompania "Kurum". Sakaq prokuroria bëri me dije se deri ditën e djeshme Lefter Sota nuk ka dorëzuar ende provat për pretendimet e tij.

isë. Prokuroria ngre dyshimet se Tahiri ka qenë në dijeni të veprimtarisë kriminale të Moisi Habilajt dhe të gjithë anëtarëve të tjerë të kësaj bande dhe ka siguruar paprekshmërinë e veprimtarisë kriminale të tyre. "Personi në hetim Moisi Habilaj në bashkëpunim me persona të tjerë, duke për-

fituar nga lidhjet e ngushta me ish-ministrit e Brendshëm dhe kundrejt shpërblyeme, kanë bërë të mundur kultivimin e sasive të konsiderueshme të lëndës narkotike, transportimin e tyre në mënyrë të organizuar me destinacion jashtë vendit", thuhet në kërkesën e prokurorisë.



Dje në Komisionin Parlamentar të Sigurisë

"Personi i dytë iku me çantën plot me para"

Berisha: Në makinën e Sotës ishte Florian Habilaj

Ish-kryeministri Sali Berisha zbardhi dje një tjetër detaj mbi ngjarjen e ndodhur në Elbasan, ku një biznesmen u arrestua, pasi iu gjet në makinë një sasi e konsiderueshme parash. Teksa publikoi në "Facebook" denoncimin e një qytetari, ish-kryeministri nxjerr një tjetër emër për personin që ka qenë në makinë bashkë me biznesmenin në momentin e ngjarjes. "Policia po bën dog gjë për të fshehur të vërtetën. Personi që ka qenë me Orest Sotën është larguar me një çantë të madhe nga makina dhe policia e ka lejuar dhe ajo e di se kush është. Po të keni parasysh foton e makinës që tregonte se euron ishin të shpërndara me tufa në sediljen e pasme, dukej qartë se një person tjetër ka qenë në makinë dhe ai në largim e sipër ka marrë ato që ka mundur. Policia nxori emrin e personit të tretë vetëm pas katër ditësh, çka do të thotë se ky Leonard është thjeshtë beden. Në policinë e Elbasanit pëshpëritet se ka qenë shoferi i Saimir Tahirit. Prandaj kërkoni të hetohet policia e Elbasanit për mashtrimet e saj", thuhet në mesazhin drejtuar Berishës.

AKUZA

Ish-kryeministri Berisha ngre akuzë për doganën e Durrësit. Referuar mesazhit të një doganieri anonim, Berisha thotë se zyrtarët po vjedhin 5 milionë dollarë në doganën e Durrësit. Ndërkaq, doganieri dixhital akuzon drejtoreshën dhe drejtorin e Antikontrabandës.

Po dje, ish-kryeministri Sali Berisha ngre akuzë për doganën e Durrësit. Referuar mesazhit të një doganieri anonim, Berisha thotë se zyrtarët po vjedhin 5 milionë dollarë në doganën e Durrësit. Ndërkaq, doganieri dixhital akuzon drejtoreshën dhe drejtorin e Antikontrabandës. Po dje, Berisha publikoi një denonim lidhur me pengmarrjen që ndodhi në Lezhë. Në adresë të ish-liderit demokrat, qytetari dixhital shkruan se personi që u mor peng është 'ushtar' i ish-deputetit të PS, Arben Ndoka.

Permbuesi gjyqësor Gentil Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurinë :
a) Tokë are e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr pasurie 11122, vullmi 5, Faqe 27, në zonen kadastrale nr 1898, me sipërfaqe totale 5990 m², e ndodhur në adresën Gur i Zi, Shkodër
b) Tokë are e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr pasurie 11456, vullmi 7, Faqe 48, në zonen kadastrale nr 1898, me sipërfaqe totale 3492 m², e ndodhur në adresën Gur i Zi, Shkodër
1. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në ankand është në masën sipç caktojme me posthë
a) për pasurinë "Tokë Are" me sip 5990 m², është në vlerën 1,920,000 lekë
b) për pasurinë "Tokë Are" me sip 3492 m², është në vlerën 1,400,000 lekë
Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 14.11.2017 ora 16.16 në Zyron e përmbuesit gjyqësorë Gentil Bushati me adresë Rruga Don Bosko, Përballë Gjykatës së rrethit Gjyqësorë Shkodër. Personat e interesuar duhet të derdhi përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100.

Permbuesi gjyqësor Gentil Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurinë :
"Apartament" me sip 127.7 m², e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr 82 date 02.06.2011 me vullmi 5 faqe 108 me nr pasurie 16130-1-8, në Zonen Kadastrale 8597 me adresë, lagja "Pazare", Shkodër
2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërpërkujtuar, është në vlerën 3,124,800 (tremilione e njëqind e njëzetatë mijë e tetëqind) lekë
Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 15.11.2017 ora 16.16 në Zyron e përmbuesit gjyqësorë Gentil Bushati me adresë Rruga Don Bosko, Përballë Gjykatës së rrethit Gjyqësorë Shkodër. Personat e interesuar duhet të derdhi përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Banken BKT dega Shkodër me nr llogarie 41064051, ose në Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100.

Permbuesi gjyqësor Gentil Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurinë :
a) Tokë are e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr pasurie 582/1, vullmi 10, Faqe 248, në zonen kadastrale nr 1100, me sipërfaqe totale 3230 m², e ndodhur në adresën Barbullush Shkodër
b) Tokë are e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr pasurie 523/21, vullmi 9, Faqe 3, në zonen kadastrale nr 1100, me sipërfaqe totale 2360 m², e ndodhur në adresën Barbullush Shkodër
1. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në ankand është në masën sipç caktojme me posthë
a) për pasurinë "Tokë Are" me sip 3230 m², është në vlerën 697,680 lekë
b) për pasurinë "Tokë Are" me sip 2360 m², është në vlerën 509,760 lekë
Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 08.11.2017 ora 16.16 në Zyron e përmbuesit gjyqësorë Gentil Bushati me adresë Rruga Don Bosko, Përballë Gjykatës së rrethit Gjyqësorë Shkodër. Personat e interesuar duhet të derdhi përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100.



Valentina Madani

Komisioni parlamentar i Sigurisë u shoqërua dje me debate të forta mes deputetëve të opozitës dhe atyre të mazhorancës për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2018. Pyetje dhe deputetit demokrat, Ervin Salianji për ministrin e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, tensionuan mbledhjen e Komisionit të Sigurisë. "Kam parasysh akuzat që janë bërë nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, që nga Ministria e Mbrojtjes nuk ka qenë disponibël sistemi i radarëve për të kontrolluar hapësirën detare në Republikën e Shqipërisë", deklaroi deputeti i PD-së. Kjo pyetje dhe deputetit demokrat, Ervin Salianji për ministrin e Mbrojtjes, Olta Xhaçka shkaktoi debate dhe tension në Komisionin e Sigurisë. Deputeti socialist, Paulin Stërkaj reagoi: "Je i karikuar si bilbil mali, ule pak tempin". Pa mikrofon, deputeti socialist Pjerin Ndreu e quajti deputetin Salianji provokator, duke i thënë: "Ti do rrahur. Se po të rrahi...", iu drejtua Stërkaj. Pikërisht ky moment u cilësua si kërcënim nga ana e deputetit demokrat, i cili në një konferencë të posaçme për mediat, tha se banditët me pushtet po kërkohjnë t'i mbyllin gojën opozitës. "Sot (dje) ishte një fakt tjetër i provuar, i asaj që ne kemi thënë prej vitesh, që Rama fle dhe zgjohet me krimin. Që Rama banditët i ka futur në parlament dhe në institucione. Që Rama kërkoi që nëpërmjet banditëve të mbajë pushtetin, por ta harrojë që banditët me, ose pa pushtet do t'i mbyllin gojën opozitës", deklaroi z.Salianji. Për çështjen reagoi deputeti socialist, Pjerin Ndreu, i cili tha se nuk ka kërcënuar deputetin demokrat, por e gjitha ka qenë në kuadër të shakasë. "E para, nuk kam kërcënuar askënd, por po bënim shaka me kolegun Stërkaj dhe Salianji menjëherë e merr seriozisht. E dyta, unë e kuptoj se ka deputetë delirantë që kërkohet alibi për ndonjë medalje në politikë dhe mezi presin të bëjnë kastravecim dhe viktimë. Por të rrinë të qetë, se nuk do i japim kënaqësinë që kërkohet me ngulim, duke provokuar në çdo rast", u shpreh z.Ndreu. Pas deklaratave të fundit të deputetit socialist se ai nuk e kishte kërcënuar, reagoi z.Salianji. "Pjerini e ka pasion kërcënimin, por në thelb është vetëm një qengji i butë që pi shumë nana... Mbarështuesi i kastraveçëve, zoti Ndreu, më ka kërcënuar dhe më ka lënë pa gjumë... dhe këшту, i shqetësuar nga kastraveçerët, mendova njëherë t'i shkruaj një letër të hapur,

"Bilbil mali", provokator, do rrahur". Deputetët socialistë përplasen me Salianjin

Sterkaj: Unë bëj mundje e boks. Salianji: Banditë, s'më trembni dot

Ndreu: Delirant, bëra shaka. PD: Të hetohet



Komisioni parlamentar i Sigurisë

DEBATI TEK KOMISIONI I SIGURISË

SALIANJI PYET XHAÇKËN: A ju duhet më shumë buxhet për të kontrolluar ish-repartet ushtarake që përdoren për magazinim droge? A ju duhet më shumë buxhet për të vendosur në funksion radarët?

STERKAJ: Je bilbil mali. Se vetëm për të folur ke ardhur.

PJERIN NDRU (PA MIKROFON): Mos i provoko të gjithë se do hash dajak. Ti do rrahur.

STERKAJ, SALIANJIT: Unë bëj mundje, boks, edhe karate. Mos më bëj mua presion.

PJERIN NDRU: Rri more urtë se je bërë provokator i keq, rri more urtë, nuk e shikon çfarë është bërë në të kaluarën.

SALIANJI: Nuk pyes dhe s'kam frikë nga asnjë bandit me, ose pa pushtet.

SHKURT

Radarët, Xhaçka: Po hidhet baltë mbi FA

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, e pranishme në Komisionin e Sigurisë ku u diskutua buxheti 2018 foli për çështjen e radarëve, duke akuzuar se opozita po hidh baltë mbi FA. "FA po kryejnë me devotshmëri dhe profesionalizëm misionin dhe detyrat për ruajtjen e sovranitetit të hapësirës detare. Sistemi i vëzhgimit të hapësirës detare është plotësisht funksional dhe në gatishmëri të plotë operacionale. Sistemi punon pa ndërprerje dhe personeli ushtarak punon 24 orë në ditë, 7 ditë të javës për të zbatuar detyrën. Nëse dikush këtu ka informacion, të dhëna, apo çfarëdo gjëje tjetër, dërgojini në organet e hetimit. Ju kërkoi të mos hidhni baltë mbi ushtarakët, që janë njerëzit e përkushtimit dhe sakrificës", tha zj.Xhaçka.

TVSH, LSI: Jo përfshirje të biznesit të vogël

LSI është kundër rritjes së taksave dhe përfshirjes së bizneseve të vogla në skemën e TVSH-së, u shpreh dje kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, në takim me kryetarin e Shoqatës së Biznesit të Vogël dhe të Mesëm, Albert Nasto. Duke i cilësuar bizneset e vogla dhe të mesme si shtyllën kurriore për ekonominë e vendit, Kryemadhi tha: "LSI mbështet biznesin e vogël dhe të mesëm".




DEBATI

Sherr mes kryetares së Komisionit të Arsimit në Kuvend, Albana Vokshi dhe ish-ministrit të Shëndetësisë, Ilir Beqja. Vokshi akuzoi ish-ministrin se reformat e bëra nga ai nuk kanë dhënë asnjë lloj efekti e aq më shumë, kanë sjellë gjëra të gabuara.



PADIA

49 deputetë të PS-së i janë drejtuar dje Gjykatës Kushtetuese me një kërkesë për të shpallur papajtueshmëri me vendimin e marrë nga KQZ-ja që kryebashkiakut të Mallakastrës, Agron Kapllanajt të mos i hiqet mandati. Deputetja Klotilda Ferhati tha se përpara kësaj pailigjshmërie, PS-ja ka vendosur t'i drejtohet Kushtetueses.



Gardisti i shkruan Bashës: Tahiri, dy zyra në Gardë

Kreu i PD-së, Luzlim Basha, publikoi dje një mesazh që i ka dërguar një punonjësi në Gardë së Republikës. Në mesazhin dërguar kryedemokratit Basha, gardisti shkruan se në 17 tetor, bashkëshortja e Saimir Tahirit ka shkruar në darkë vonë në zyrën e ish-ministrit në institucionin e Gardës. Sipas tij, aktualisht ish-ministri Tahiri ka dy zyra në Gardën e Republikës, të cilat i administron. Sipas Bashës, kjo provon faktin se kryeministri Rama e ka mbrojtur Tahirin duke i dhënë kohë, që ky i fundit të shkatërronte provat në këmbim të heshtjes. "Ja pse Rama e mbrojt Tahirin nga arresti, shkatërron provat në këmbim të heshtjes: Jam një punonjës në Gardë. Me datë 17 tetor zonia e Saimir Tahirit ka ardhur në darkë vonë dhe ka qëndruar në ish-zyrën e Saimir Tahirit rreth 5 orë. Aktualisht Saimir Tahiri ka dy zyra në Gardën e Republikës, të cilat i administron dhe para 10 ditëve ka ardhur natën dhe ka qëndruar disa orë", thuhet në denoncimin drejtuar kreut të PD-së.

kryekastraveçeritësit të atdheut tonë, që të më çojë nja dy roje nga 100 rojet e veta të Gardës... Mirëpo kur i kish të shkruar në vesh kryeministrit kastraveçeritësit kërkese ime, më çoi falë e më tha se Pjerini e ka pasion kërcënimin, por në thelb është vetëm një qengji i butë që pi shumë nana... Sepse është malësor i zbutun dhe ka dëshirë t'i ulërijë Hënës, si dikur kur ishte ujë malcie, po qyteti e ka zbut, kurse politika e ka bërë kunadhe... Laq për sot Pjerin", deklaroi



deputeti i PD-së. Partia Demokratike reagoi ashpër pas pretendimeve të opozitës se Ndreu kërcënoi Salianjin. PD dënoi kërcënimin ndaj deputetit Salianji, ndërsa i bëri thirrje prokurorisë që të hetojë Ndreun dhe Stërkajn. Mes të tjerash, PD akuzon Ndreun si të përfshirë në trafikun e drogës. "PD i kërkoi prokurorisë të hetojë këtë kërcënim mafioz e banditesk nga një recidivist i dhunës dhe kërcënimeve në Kuvend si Pjerin Ndreu dhe



Ligji, Bylykbashi: T'ua çojmë Habilajve

Mbledhja e Komisionit të Ligjeve u shndërrua dje në përplasje deklarata të forta mes opozitës dhe opozitës. Deputeti i PD-së, Oerd Bylykbashi i është drejtuar kreut të komisionit, Ulis Manjas, duke i thënë se është më mirë që "këtë ligj t'ua çojmë Habilajve për konsultim". Nga ana tjetër, Manja i është përgjigjur: "mund t'ia çojmë edhe kreut të Bashkisë Mallakastër apo prokurorit për të mbyllur dosjen". Pas debateve të ashpra si në sallën e Komisionit të Sigurisë, edhe në atë të Ligjeve, deputetët e opozitës braktisën mbledhjen.

kolegu i tij, Stërkaj. U kërkoi edhe partnerëve ndërkombëtarë të monitorojnë këtë rast e të kuptojnë se krimi i përfaqësuar në parlament, krimi si zgjedhje e ortakëri e Edi Ramës nuk mund të jetë zgjidhje për luftën ndaj krimin dhe drogës. Krimi është në pushtet prej Edi Ramës dhe vetëm me largimin e tij mund të ketë luftë të vërtetë ndaj krimin dhe të lirimit nga mafia e banditit", thuhet në deklaratën e PD-së.

Ndryshimi i formulës së taksimit mbi të ardhurat, ministri shpjegon efektet

Ornela Manjani

Ahmetaj: Taksim progresiv për çdo të ardhur, preken 1500 të punësuar

Jorida Tabaku: Qeveria shpik rritje taksash për të rritur të ardhurat

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj ka shpjeguar efektet që do të ketë për qytetarët ndryshimi i formulës së taksimit mbi të ardhurat. Ministri Arben Ahmetaj, shpjegoi dje se taksimi progresiv mbi të gjithë të ardhurat është shumë i ndershëm dhe përfshijë shumicën e shqiptarëve. Niveli i lartë i këtij taksimi kap një numër të vogël pagash. "Sistemi progresiv ka funksionuar në mënyrë të shkëlqyer dhe ka liruar nga ngarkesa fiskale 97 për qind të të punësuarve në Republikën e Shqipërisë. 23 përqindësi që ta dini, paguajnë vetëm 1500 veta në Republikën e Shqipërisë. Ta dinë qytetarët. Pra, të nderuar qytetarë 23 për qind paguajnë 1500 të punësuar që marrin një pagë mbi 4 milionë lekë të vjetra." Por kundër këtij perceptimi është deputetja e PD, Jorida Tabaku, sipas së cilës, qeveria po varfëron shtresën e mesme, si dhe do të rrisë evazionin në mbledhjen e kësaj takse. "Qeveria është duke shpikur mënyra të reja se si të rrisë të ardhurat nga rritja e taksave. Duke qenë se ka ezauruar të gjitha mundësitë për rritje taksash, duke qenë që kemi nivelin më të lartë të tatimit mbi të ardhurat personale, të tatimit mbi fitimin në rajon, është duke konceptuar mënyra të reja se si mundet që të taksojë sa më shumë qytetarët. Kjo nuk është gjë e re, sepse është një politikë që ka ndodhur gjatë këtyre



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj

katër viteve, por kjo do të vazhdojë do të penalizojë akoma dhe më shumë shtresën e mesme, e cila për momentin është shtresa që paguan taksat më të larta në rajon. Tatimi nga të ardhurat personale është

një taksë që ka pasur nën performim, të paktën gjatë 4 viteve të fundit dhe ka treguar që rritja e vazhdueshme e taksave nuk prodhon rritje të të ardhurave. Rritja e vazhdueshme e taksave ka prodhuar dhe ka

nxjitur evazionin." Gjatë diskutimit në Kuvend të buxhetit dhe paketës fiskale të vitit të ardhshëm, ministri i Financave Arben Ahmetaj bëri publike idenë e tatimit progresiv të integruar të të ardhurave. Kjo nënkupton

se të gjitha të ardhurat e individit (paga + të ardhurat nga dividendi + të ardhurat nga qiratë si dhe çdo e ardhur tjetër) të tatonen në total në përqindjen e përcaktuar në shkallën e tatimit progresiv.

FORMULA E RE

Aktualisht, qeveria takson progresivisht vetëm pagat, ndërsa të ardhurat e tjera, si qiraja apo e drejta e autorit taksohen me normë fikse, 15 për qind. Sipas skemës së re, të gjitha të ardhurat do të bashkohen në një bazë të vetme, mbi të cilën pastaj zbatohet taksa progresive 0, 13 ose 23 për qind, në vartësi të nivelit të të ardhurave. Ndryshimi sjell dy efekte. Rasti i parë është një individ, i cili aktualisht ka një pagë 130 mijë lekë në muaj dhe një të ardhur nga qiraja 30 mijë lekë në muaj. Për këtë individ, taksa rritet. Ajo shkon nga 17 mijë e 500 lekë në muaj, që është aktualisht, në 19 mijë e 900 lekë në muaj. Pra, 2 mijë e 400 lekë më shumë në muaj. Rasti i dytë është një individ tjetër, i cili e ka pagën 60 mijë lekë në muaj dhe një të ardhur nga qiraja po 30 mijë lekë në muaj. Për këtë qytetar, taksa ulet. Ajo shkon nga 8 mijë e 800 lekë në muaj, që është aktualisht, në 7 mijë e 800 lekë, duke u ulur me 1 mijë lekë në muaj.

DEBATI

ERJON BRAÇE: Shoh që në 24.5 miliard lekë borxh i trashëguar doganor, më shumë se 55% e tij zotërohet nga 6 kompani, ku këto kompani bëhen pjesë e tregut, për fat të keq, krijojnë borxh fiskal, për fat akoma edhe më të keq borxhohen duke marrë kredi dhe, për fat të mirë, apo fat të keq pastaj zhduken nga tregu.

JORIDA TABAKU: Kjo qeveri sigurisht që është gjykuar për rritjen e të ardhurave që ka prodhuar informalitetin, që ka prodhuar evazionin, por besoj ky buxhet duhet të shërbente për të mësuar nga e kaluara. Nuk mundet që t'i rrisim pafundësisht taksat, nuk mund të rrisim pafundësisht ngarkesën fiskale për bizneset e vogla për qytetarët dhe të lejojmë evazionin të bizneset e mëdha.

Skema, si do ndiqen detyrimet e prapambetura

Bashkia e Tiranës bën gati sistemin e ri për taksat

Bashkia e Tiranës ka vendosur që të prokurorë një sistem të qendëruar për monitorimin e detyrimeve të prapambetura dhe përmirësimin e kontrollit. Në dokumentacionin shoqëruar të procedurës thuhet se sistemi aktual e bën të vështirë ndjekjen e këtyre detyrimeve pasi një pjesë e procedurës është shkresore. Aktualisht Drejtoria e Përgjithshme e Tatim Taksave Vendore ka e vetme rolin bazë për informimin për taksat e tarifave, regjistrimin e bizneseve dhe qytetarëve, llogaritjen e detyrimeve, rillogaritjen, kontrollin e territorit dhe bizneseve, mbledhjen e taksave dhe tarifave si dhe mbledhjen me forcë të detyrimeve. Të gjitha këto procedura e ngarkojnë atë duke e bërë të vështirë menaxhimin dhe sjellin nevojën e një sistemi të ri të informatizuar dhe qendëruar.



"Zgjidhja që kërkohet është një sistem, i cili me ndërhyrje minimale nga ana e punonjësve të bashkisë të mund të ndjekë efektivisht të gjithë rastet e detyrimeve të prapambetura me qëllim arkëtimin e tyre në kohën më të shkurtër të mund-

shme. Identifikimi i këtyre rasteve duhet të vijë si rrjedhojë e të dhënave të marra përmes integritimit të sistemeve ekzistuese të taksave dhe financiare të bashkisë, të dhënave të marra përmes kontrollit të agjentëve në terren dhe vetëdeklarimeve

të subjekteve përmes një ndërfaqjeje online që do u ofrohet" thuhet në specifikimet teknike. Bashkia nga ana tjetër synon që informatizimi të shërbejë në rritjen e të ardhurave. Sistemi i ri pritet t'i kushtojë bashkisë rreth 45.5 milionë lekë, të paktën kaq është fondi limit. Aktualisht Drejtoria e Përgjithshme Vendore për Taksat dhe Tarifave vendore është për ndjekjen mbledhjen, dhe realizimin e të ardhurave të planifikuara sipas vendimeve të këshillit bashkiak dhe më konkretisht për: taksën mbi ndërtesën, taksa mbi tokën bujqësore, taksa mbi truallin, taksa e fjetjes në hotel, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ngadërtimit e reja, taksa e tabelës, taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore.

Hidrokarburet, Gjijnuri: Konsulencë amerikane për regjimin fiskal

Ministri i Infrastrukturas dhe Energjisë, mori pjesë sot në tryezën e mbështetur nga Departamenti Amerikan i Shtetit, Byroja e Burimeve Energetike, Departamenti Amerikan i Tregtisë dhe ai i Thesarit, me temë "Kornizat fiskale dhe kontraktuale për zhvillimin e sektorit të hidrokarbureve". Konferenca shërben për ofrimin e një perspektive globale mbi praktikën më të mira në kontraktimin dhe regjimet fiskale në naftë dhe gaz me synim që Shqipëria të mund të tërheqë sa më shumë investime në këtë fushë. Në fjalën e tij ministri Gjijnuri theksoi se Shqipëria ka burime hidrokarbure dhe mund të përfitojë në shumë prej tyre, po Shqipëria ka nevojë për një kuadër rregullator, përmirësim të legjislacionit dhe mbi të gjitha drejtim të kapaciteteve të nevojshme qoftë nga autoritetet fiskale qoftë nga autoritetet e mbikëqyrjes së burimeve natyrore. "Pasuritë e naftës dhe gazit shpesh herë janë edhe burim konfliktesh kontraktore. Shpesh herë ku ka naftë e gaz ka edhe përplasje mes qeverisë dhe kontraktorëve privatë. Edhe ne kemi qenë dëshmitarë i atyre përpljeve modeste që kemi bërë dhe konfliktet juridike që kemi filluar me kompaninë, por është momenti që ne të mendojmë përtej eksperiencës tonë të shkurtër në këtë drejtim. Është momenti që të realizojmë edhe një kuadër më të mirë fiskal dhe rregullator pse jo të ndryshojmë edhe modelet tona të kontratës." tha Gjijnuri. Ministri theksoi më tej se në bashkëpunim me Ministrinë e Financave si edhe me një asistencë ndërkombëtare nga departamenti amerikan i shtetit, po punohet për të hartuar një sistem më të thjeshtë fiskal. "Kuptohet, - vijoi më tej Gjijnuri - se kjo mund të hapë edhe debat me kontratat ekzistuese. Ne jemi për respektimin e marrëveshjeve, nuk dua të jap këtu mesazhin që Shqipëria në mënyrë të njëanshme do të ndryshojë marrëveshjet, por pse jo të hapim një diskutim të drejtë, sepse marrëveshjet bëhen të qëndrueshme kur secila palë të marrë atë që i takon."

Presidenti Ilir Meta: KLD të nisë urgjentisht verifikimin e rastit

KRUJË

Gjykata e Krujës ka liruar me kusht Genc Tafilin, i dënuar me 25 vite burg për bashkëpunim në vrasjen e kolonelit Arben Zylyftarit. Vendimi për lirimin e tij është dhënë nga gjykatësja e Krujës, Enkelelda Hoxha, e cila pranoi kërkesën e të dënuarit, të cilit i kishin mbetur më shumë se 3 vite burg që të dilte në liri të plotë. Genc Tafili ndodhej në burg që prej 2 gushtit të vitit 2000, pasi u vu në prangë menjëherë pas ekzekutimit të ish-drejtorit të policisë së Shkodrës. Asokohe policia organizoi një aksion për kapjen e Bari Tafilit, person i shpallur në kërkim, por pati një shkëmbim zjarri. Në atë ngjarje mbetën të vrarë Bari Tafili dhe koloneli Zylyftari. Genc Tafili është vëllai i Admir Tafilit, i dënuar me burg të përjetshëm për vrasje. Pas lirimit nga burgu të të dënuarit në fjalë, ka reaguar prokuroria e Krujës. Burime zyrtare nga ky institucion dje bënë me dije se lirimi është i paligjshëm, ndërsa kërkohet që Këshilli i Lartë i Drejtësisë të verifikojë vendimin e gjyqtarës Enkelelda Hoxha. Gjithashtu, në lidhje me lirimin me kusht dhe para kohe të Genc Tafilit ka reaguar edhe Presidenti i Republikës, Ilir Meta. Ai ka kërkuar që KLD të nisë verifikimin në lidhje me rastin në fjalë.

DEKLARATA E PLOTË E PROKURORISË

Gjyqtarja Enkelelda Hoxha ka pranuar kërkesën e të dënuarit Genci Tafili, i cili vuante dënimin në LEVP Fushë-Krujë për lirim para kohe me kusht dhe ka urdhëruar lirimin e tij të menjëherëshëm nga vendi i vuajtjes së dënimit, duke e urdhëruar atë që të mbajë kontakt me Zyrën e Shërbimit të Provës, Krujë.

Ekzekutoi kolonelin Arben Zylyftari, gjykata liron nga burgu Genc Tafilin

Prokuroria: Vendimi, në kundërshtim me ligjin



Genc Tafili

Ja çfarë ka thënë Genc Tafili për vrasjen e ish-komisar Zylyftarit

Shteti asnjëherë nuk u mundua të zbardhte ngjarjen që na shkatërroi. Si u vra Zylyftari? Pse u soll ai në operacionin për kapjen e babait tim, kur ky lëvizte çdo ditë nëpër qytet, në peshkim ku kishin biznesin dhe mund të kapej kurdo? Gjithçka ishte kurth për të vrarë Arben Zylyftarin. Ai më ka vrarë babën të dorëzuar, dhe desh të më vriste dhe mua për

Prokuroria e Krujës vlerëson se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Krujë është marrë në kundërshtim të hapur me ligjin dhe se përbën shkak që nëse çmohet si i tillë edhe nga ju, të informohet Këshilli i Lartë i Drejtësisë për të verifikuar veprimtarinë në kundërshtim me ligjin të gjyqtarës për këtë rast.

I dënuari Genci Tafili, që

është liruar me kusht ka qenë duke vuajtur dënimin për veprën penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", parashikuar nga neni 79/c të K.Penal. Konkretisht bëhet fjalë për vrasjen e drejtorit të Policisë së Shkodrës, Arben Zylyftari dhe i kishin mbetur për të vuajtur më shumë se tre vjet burgim.

Megjithëse ai rezultoi të jetë një person me rreziksh-

më të lartë, as kjo rrethanë dhe as rrethanat e tjera të parashikuara në ligj nuk janë marrë në konsideratë nga gjyqtarja në fjalë. Neni 64 i K.Penal, "Lirimi me kusht" parashikon shprehimisht se "... nuk lejohet liri me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje, si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parash-

REAGIMI I METËS

Në cilësinë e kreut të KLD-së, Presidenti Meta ka kërkuar të nisë menjëherë verifikimin në përputhje të plotë me ligjin për procedurat e ndjekura nga Gjykata e Krujës në lidhje me vendimin e dhënë për lirimin me kusht të Genc Tafilit. "Presidenti i Republikës garanton se pretendimet e institucionit të Prokurorisë do të verifikohen nga Inspektorati dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në përputhje me kushtet dhe kriteret e ligjit", thuhej në reagimin për mediat të Presidentit Meta.

ikuara nga nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i neni 100 të K.Penal".

Në rastin konkret, megjithëse dispozita ndaluese për nenin 79/c është një dispozitë urdhëruese dhe për këtë shkak prokurori në seancë ka kërkuar që të rrezohet kërkesa e të dënuarit, në mënyrë flagrante gjykata e ka injoruar këtë pengesë ligjore dhe në shkelje të plotë të ligjit ka urdhëruar lirimin e tij.

Vendimi i gjykatës është ankumuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë që të nesërmen e dhënies së tij dhe me do të vazhdojmë të ndjekim në vazhdimësi ecurinë e procesit.



I arrestuari Elvis Hoxha

Vrasja e 23-vjeçarit, gjykata lë në burg 2 të akuzuarit

SHKODËR - Gjykata e Shkodrës ka dhënë dje masën e sigurisë "arrest me burg" për 17-vjeçarin Elvis Hoxha, i cili akuzohet për plagosjen me pasojë vdekjen të 23-vjeçarit Hermes Beqiri. Gjithashtu, togat e zeza të qytetit verior lanë në qeli edhe 17-vjeçarin Ditmir Harifi, që akuzohet si bashkëpunëtor në krim, duke qenë se ka ndihmuar autorin që të largohet nga vendi i ngjarjes. Ndërsa, Bekim Turishta, i akuzuar për "moskallëzim krimi" në këtë ngjarje u la me masën e sigurisë "arrest shtëpie" me mbikëqyrje elektronike. Në sallën e gjyqit, autori i dyshuar, Hoxha nuk ka bërë asnjë lloj deklarate, përveçse ka konfirmuar gjeneralitetet. Po ashtu, edhe Ditmir Harifi nuk ka bërë asnjë deklarate përpara gjyqtarit Besmir Stroga. Prokuroria e çështjes, Shqiponja Milla kërkoi lënim në burg pa afat ndaj dy të akuzuarve për ngjarjen e rëndë që ndodhi mbremëjen e të shtunës që shkoi. Nga ana tjetër, avokati mbrojtës, Anton Kosteri i caktuar kryesisht, kërkoi masë lehtësuese "arrest shtëpie" me mbikëqyrje elektronike, duke pasur parasysh moshën e re të të akuzuarve. Në fund, gjykata pranoi kërkesën e prokurorisë duke i lënë dy të rinjtë në qeli. Pas ngjarjes së rëndë, burime nga policia deklaruan se ngjarja në lagjen "Guerrile" ndodhi pas një konflikti mes të rinjve për një kapele.

United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: – the "Assessment on level of adoption and impact of Standard of Operating Procedures at Municipal Level in Albania" for STAR 2 Project

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP/RFP 42286**

RFP for "Assessment on level of adoption and impact of Standard of Operating Procedures at Municipal Level in Albania" for STAR 2 Project

For more details please refer to the link below:
<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/>

Relevant dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than 14 November 2017

Address for communications:
Email: procurement.al@undp.org
Or
Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor
Tirana, Albania

Caritas Shqiptar Albania

LAJMËRIM PËR KONTRAKTIM KOMPANIE NDËRTIMI

Caritas Shqiptar kërkon të kontrakttojë një kompani ndërtimi për të kryer punime si:

- Rinovimin dhe mobilimin e një ambjenti të përcaktuar si dhomë intervistimi në Drejtorinë Rajonale të kufirit dhe Migracionit në Shkodër.
- Rinovimin dhe mobilimin e një ambjenti të përcaktuar si dhomë intervistimi në Drejtorinë Rajonale të kufirit dhe Migracionit në Kukës.

Informacionin për zhvillimin e këtij tenderi mund ta gjeni duke u interesuar në adresën e facebook-ut: "Caritas Albania-Shqiptar".

Afati i fundit i dorëzimit të ofertave: **10.11.2017, ora 14:00.**

Adresa për dorëzimin e dokumentacionit:

Rruga "Don Bosko", Nr. 4 Tiranë;
Tel: + 355 4 22 30088; Fax: + 355 4 22 34327

Investimi, 700 milionë lekë brenda 7 vitesh

Nikolla: Paga më të larta për mësuesit, buxheti për arsimin pëson rritje me 10.52%

Gjatë vitit 2018, buxheti për arsimin është rritur me 10.52%, çka konsiston edhe në rritjen e pagave për punonjësit e këtij sektori. Lajmi është bërë më dije nga ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë Lindita Nikolla, e cila prezantoi buxhetin në Komisionin parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Sipas ministres, buxheti për arsimin në vitin 2018 arin shifrën 38 miliardë e 374 milionë lekë shpenzimet korrente të rritura

LINDITA NIKOLLA

"Totali i fondeve buxhetore të Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë në këtë program buxhetor është në shifrën 38 miliardë e 374 milion lekë, krahasuar me planin fillestar të vitit 2017 kemi një rritje prej 3.6 miliardë lekësh apo 10.52% më shumë".

përkthehen në rritje pagash. "Totali i fondeve buxhetore të Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë në këtë program buxhetor është në shifrën 38 miliardë e 374 milion lekë, krahasuar me planin fillestar të vitit

2017 kemi një rritje prej 3.6 miliardë lekësh apo 10.52% më shumë. Rritja konkretisht reflektohet në shpenzimet korrente, të cilat në total janë shtuar me 2.6 miliardë lekë dhe përfaqësojnë kryesisht rritjen e pagave

në sektorin e arsimit", theksoi Nikolla gjatë diskutimit. Kjo e fundit në vazhdim të prezantimit, theksoi se është parashikuar që 76% e buxhetit të shkojë për arsimin parauniversitar. "Fondet e destinuar për arsimin parauniversitar 2018 përfshijnë 76.27% të buxhetit të Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë, e cila për Bashkinë e Tiranës; ku identifikohet edhe raportit më i lartë i nxënësve në klasa; do ndërtohen 17 shkolla të reja ku, që prej 2018



MASR do kontribuojë me një buxhet vjetor 700 milionë lekë për një periudhë 7 vjeçare", - shtoi më tej ministria. Gjatë këtij prezantimi, pati edhe debate për buxhetin mes deputetëve të mazhorancës dhe opozitës. Kryetarja e komisionit, Albana Vokshi i kërkoi de-

putetëve dhe ministres së Arsimit, Nikolla që të dorëzojnë mandatet. Para disa ditësh, edhe ministri i Financave, Arben Ahmetaj tha se pagat e 31 mijë mësuesve në mbarë vendin do të rriten me 5% dhe efektet financiare do të nisnin në korrik të vitit të ardhshëm.

Dekania: Programi i ri, nevojë e domosdoshme e kërkesave të shumta të tregut

Kolegji Universitar "Luarasi" çel masterin profesional mbi sigurinë

Rezana Konomi: Kjo është një risi në arsim

Voltiza Duro

Kolegji Universitar "Luarasi" tashmë iu jep mundësinë të gjithë studentëve që të ndjekin studimet në ciklin e dytë, master profesional "Për sigurinë dhe rendin publik". Nëpërmjet këtij programi studimi mund të vijojnë të specializohen edhe punonjësit e strukturave të sigurisë së rendit publik dhe privat. Në vendin tonë, rreth 31 mijë punonjës në sferën publike, por edhe private, janë pjesë e sektorit të sigurisë dhe rendit publik. Programi më i ri i masterit profesional që ofron Kolegji Universitar "Luarasi" ka për qëllim të nxjerrë ekspertë në çështje të reja të studimeve strategjike dhe të sigurisë, të aftë të përballojnë angazhimin eventual në çështje që lidhen me zhvillime aktuale ekonomike, politike në shkallë lokale apo dhe globale. Dekania e Fakultetit të Drejtësisë, Prof. Rezana Konomi thotë për "News 24", se dega e re e studimit master profesional "Për sigurinë dhe rendin publik" është një risi e ofruar vetëm nga Kolegji Universitar "Luarasi" pas kërkesave të shumta të të interesuarve pas studimit të tregut. "Është hera e parë, pas një shkëputjeje kohore që ne bëjmë aktiv një master profesional. Kjo erdhi si nevojë e domosdoshme e kërkesave të tregut dhe kërkesave që kishin stu-



Dekania, Rezana Konomi

dentët sivjet për masterat profesionalë. Mund të them që masteri "Për sigurinë dhe rendin publik" ishte një nga masterat, të cilin ne pasi studiuam tregun, e pamë që asnjë fakultet tjetër, asnjë universitet apo kolegji universitar, privat apo publik nuk e ofronte këtë program studimi", - tregon dekania. Sipas saj, target-grupi që ka shprehur më tepër interes për të ndjekur këtë master janë të gjithë punonjësit e policisë, ata që shërbejnë në forcat e armatosura. Më tej, Prof. Rezana Konomi thotë se programi i ri i studimeve të

ciklit të dytë "Master profesional për sigurinë dhe rendin publik" iu jep mundësi një zinxhiri institucionesh, që kanë për objekt çështjet e sigurisë dhe nevojë për personel me njohuri të nevojshme akademike në këtë fushë. Dekania shprehet se masteri më i ri në fushën e sigurisë ka interes për disa arsye. "Kriteret hyrëse për në masterin profesional kanë një diapazon më të gjerë, pra mjafton të ketë mbaruar ciklin e studimeve Bachelor që mund të jetë në shkencat e Drejtësisë, por jo vetëm, ndoshta dhe Akademinë e

KRITERET

"Programi master profesional "Për sigurinë dhe rendin publik" është një risi e ofruar vetëm nga Kolegji Universitar "Luarasi". Kriteret hyrëse për në masterin profesional kanë një diapazon më të gjerë, pra mjafton të ketë mbaruar ciklin e studimeve Bachelor që mund të jetë në shkencat e Drejtësisë, por jo vetëm. Gjithashtu, kandidatët duhet të plotësojnë kriterin e mesatares që është mbi 6, sipas vendimit të qeverisë".

Rendit dhe shumë të tjera. Dhe gjithashtu kandidatët duhet të plotësojnë kriterin e mesatares që është mbi 6, sipas vendimit të qeverisë. Ka interes, sepse është një master profesional që zgjat vetëm një vit akademik dhe përfshin brenda vetes 60 kredite. Kështu që të gjithë ata që janë edhe në marrëdhënie pune janë shumë të interesuar të ndjekin këtë master profesional me kohëzgjatje të shkurtër dhe njëkohësisht të fitojnë një specializim të caktuar që ua kërkon vendi i punës", - u shpreh Konomi.



Meta: Më shumë kontribut nga brezat e rinj

65-vjetori i Fakultetit të Mjekësisë Veterinare në UBT

Presidenti i Republikës, Ilir Meta zhvilloi dje një vizitë në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare të Universitetit Buqësor të Tiranës, me rastin e 65-vjetorit të krijimit të saj. Ky fakultet është një nga qendrat më të vjetra të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në Shqipërinë e pas Luftës së Dytë Botërore. Presidenti Meta u prit nga Rektori i Universitetit Buqësor të Tiranës si dhe Dekani i Fakultetit të Mjekësisë Veterinare. Presidenti i Republikës, në fjalën e tij theksoi se Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka mundur të realizojë me sukses edukimin dhe arsimimin profesional të specialistëve të kësaj fushe të ekonomisë për ruajtjen e shëndetit të kafshëve dhe më tej për shëndetin publik. "Është e domosdoshme që brezat e studentëve që mbarojnë këtë fakultet të zhvillin e blegtorisë në tërësi, e veçanërisht në prodhimin e qumështit, mishit, vezëve, mjaltit. Ajo është baza e zhvillimit të bujqësisë." Edhe industria jonë agro-përpunuese është shumë e rëndësishme, sepse ajo është e lidhur drejtpërdrejt me prodhimin vendas, sasinë dhe cilësinë e tij konkurruese dhe kërkon kontributin shkencor të stafit tuaj akademik", - tha Presidenti. Gjithashtu Meta, duke nënvizuar se ekonomia shqiptare ndodhet përballë sfidës së madhe të integritimit në Bashkimin Evropian, vuri theksin te domosdoshmëria për të rritur prodhimin blegtorial, për punësimin dhe për eksportet shqiptare, por mbi të gjitha plotësimin e standardeve të kërkuara nga Bashkimi Evropian dhe tregu i vendeve të tij anëtarë. Presidenti Meta uroi dhe përgëzoi dekanin e Fakultetit prof. dr. Luigj Turmalaj dhe rektorin prof. Bahri Musabelliu për këtë transformim të jashtëzakonshëm të Fakultetit të Veterinarisë me infrastrukturë moderne dhe bashkëkohore në shërbim të studentëve dhe specialistëve të veterinarisë.

PRESIDENTI

"Është e domosdoshme që brezat e studentëve që mbarojnë këtë fakultet të kontribuojnë në zhvillimin e blegtorisë në tërësi, e veçanërisht në prodhimin e qumështit, mishit, vezëve, mjaltit. Ajo është baza e zhvillimit të bujqësisë."

VIP

Suplement
Pages

Enë mërkurë 8 Nëntor 2017 GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- Mbeti jashtë Kuvendit, ja çfarë bën Muhedini i PDIU-së
- Kreu i Grupit të PS-së pastron territorin bashkë me djalin e tij, Robin
- Bëri burg për vjedhje, ish-ministri Ksera nis politikën në Greqi
- Edi Rama shkon për inspektim në Fier, vishet me çitjane

Marina Vjollca shtatzënë? Ja foto që ngriti dyshimet



Kush është djali nga Tirana që i ka rrëmbyer zemrën seks simbolit

Përçahen "Babastars" / Albert Krasniqi publikon SMS drejtuar Getoarit: E ke bërë monopol



Fjolla Morina

gjen të dashur të ri

Pas ndarjes nga partneri, këngëtarja shfaqet më e lumtur se kurrë




Pas ndarjes nga partneri, këngëtarja shfaqet më e lumtur se kurrë

Fjolla Morina

gjen të dashur të ri

Kush është djali nga Tirana që i ka rrëmbyer zemrën seks simbolit



Ajo është ndër femrat më seksi në showbizin tonë. Daljet e saj publike, këngët, jeta private ka qenë gjithnjë në fokus të mediave. Ndonëse karriera ka ecur mirë për Fjolla Morinën, jeta private është përfolur jo pak. Duket se bukurshja nga Kosova nuk ka shumë fat në dashuri. Pas ndarjes nga i dashuri, brunia seksi është përfolur shumë për historitë e saj. Vetëm pak kohë më parë Fjolla i ka dhënë fund lidhjes që kishte me një djalosh nga Tirana. Kujtojmë se në atë kohë këngëtarja nisi të postonte foto me djaloshin, por pa ia publikuar imazhin. Në intervistat që ajo jepte shprehte se partneri i saj ishte xheloz, ndoshta kjo është një nga arsyet e ndarjes së çiftit. Në mediat kosovare, Fjolla pranoi se ishte ndarë, duke thënë se tashmë historia i përkiste të shkuarës. Edhe pse ka deklaruar se është single, mamaja e dy vajzave është parë shpesh në Tiranë nën shoqërinë e një djaloshi. Miqtë e afërt bëjnë me dije për "GSH" se Fjolla dhe djaloshi në fjalë kanë nisur të njihen së bashku duke ia kaluar mirë në shoqërinë e njëri-tjetrit. Ndoshta është herët për të folur për një të ardhme në lidhjen e tyre, por duket se këngëtarja është më se e lumtur në këtë moment të jetës së saj. Me aq sa kemi mundur të mësojmë, djali në fjalë është

të biznesmen dhe janë njohur së bashku nga shoqëria e përbashkët. E duket se për Fjollën ky është një moment i mirë në jetën e saj. Me dy vogëlushet, me mamanë që e ka afër në çdo hap si dhe me një karrierë të mirë, këngëtarja është më se gati ta provojë edhe njëherë dashurinë. Kujtojmë se brunia seksi këtë vit merr pjesë edhe të "Kënga Magjike". Ajo ka vendosur ta sprovtojë veten

në këtë garë me një këngë ritmike, në bashkëpunim me artistin Blake. Ajo është shfaqur mjaft provokuese dhe me stil gjatë performancës së saj, e cila për një moment dërgoi të gjithë spektatorët në atmosferën e Karnavaleve të Brazilit. Veshur në të kuqe dhe përlot me pupla, këngëtarja nga Kosova duke shkëlqyeshëm me stilin e saj.





Martesa e saj bëri bujë të madhe në mediat rozë, ku u përfol çdo detaj. Bëhet fjalë për moderatoren, e cila para pak ditësh i është rikthyer ekranit dhe publikut, të cilit vërtetë se i kishte munguar. Por kësaj here, edhe më e buzëqeshur. Është dëshmuar përmes shumë fotografive që ka një jetë të lumtur martesore me Getoar Selimin, ndërkaq në paraqitjen e saj në edicionin e parë të emisionit që kishte paralajmëruar, shihen disa shenja tjera... Edhe pse është ende herët të vërehet, por duket qartë se barku i saj ka filluar të marrë tjetër formë. E në qoftë ashtu, vërtetë një gëzim i madh për çiftin dhe mijëra ndjekës të tyre.

MARINA VJOLLCA shtatzënë?
Ja foto që ngriti dyshimet


LUANA, superseksi në spektaklin e saj,
por një mizë në kokë i prish pamjen




Luana Vjollca është shtfaqur së fundmi me programin e saj më të ri, i cili transmetohet të shtunave mbrema dhe ka në fokus argëtimin e shikuesve. Por këtë puntatë një shikues është argëtuar edhe më shumë kur ka parë "një personazh të pafutur" në kokën e Luanës. Ai ka shkrepur një foto nga ekrani gjatë transmetimit ku ka pikasur një mizë mbi flokët biondë të moderatores.

PËRÇAHEN "BABASTARS"
Albert Krasniqi publikon SMS
drejtuar Getoarit: E ke bërë monopol

Këto ditë grupi i njohur "Babastars" janë ballafaquar me disa mospajtime mes tyre. Ishte fillimisht njëri nga anëtarët, Albert Krasniqi, i cili kishte shkruar për pakënaqësitë, duke thënë se Geti dhe një nga menaxherët, Dekori, po bëjnë padrejtësi për anëtarët e tjerë të këtij grupi. Alberti ka publikuar një bisedë që ka zhvilluar në "Viber" me Getin, ku edhe shpreh pakënaqësitë e tij, duke shkruar se ai po merret më shumë me Majkun sa u përket datave, ndërsa interesimi për Skivin, Cozman dhe Onatin është shumë i vogël. "Arsyeja që jom jasht BS Monopol", kishte shkruar Alberti sipër kesaj fotografie. Por, duket se anëtarët e këtij labeli kanë rregulluar raportet mes tyre. Vetëm pak orë më parë në llogarinë e tij në "Instastory" reperi i njohur, Cozman ka publikuar disa fotografi, ku bën të ditur se labeli "Babastars" nuk janë ndarë. "Për ata që s'i din do sene thi sis Lafamilia BABASTARS 4Life", shkruan Cozman.



Arsyeja qe jom Jasht BS Monopol

BULEVARDI

POLITIK



Mbeti jashtë Kuvendit, ja çfarë bën Muhedini i PDIU-së

Tahir Muhedini ishte një ndër ligjvënësit shqiptar që mbeti jashtë parlamentit në zgjedhjet parlamentare të 25 qershorit. Pamundësia për të qenë pjesë e parlamentit duket se e ka larguar paksa ish-deputetin nga jeta politike. Muhedini është shkëputur nga realiteti i hidhur politik, i mbushur me përplasje, akuza e debate të forta mes palëve për drogen e krimin. Ish-deputeti i PDIU duket se ka shkuar në një vend të largët, aty ku jetojnë kafshët e egra, duke marrë një 'mision fisnik', zbutjen e tyre. "Duke punuar për zbutjen e kafshëve të egra!", shkruan ish-deputeti në "Facebook". Ndërkohë, ai ka postuar disa foto dhe video, ku shfaqet në mes të dy tigrave.



Kreu i Grupit të PS-së pastron territorin bashkë me djalin e tij, Robin

Kreu i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, i është bashkuar nismës për pastrimin e njësisë administrative Papër. Pa kostum, me dorezat e pastrimit në duar, bashkë me të birin, Balla ka dhënë shembullin e tij si ambientalist. "Photo of the day: Bashkë me tim bir Robin ju bashkuam nismës për pastrimin e shesheve dhe anëve të rrugëve nga mbetjet plastike. Sot në njësinë administrative Papër, Bashkia Elbasan. Faleminderit mikut tim ambientalist Mentor Kikia dhe vullnetarëve të tjerë. #ShqipëriaqëDuam #ShqipëriePastër", shkruan socialisti.

Bëri burg për vjedhje, ish-ministri Ksera nis politikën në Greqi

Spiro Ksera, ish-ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta kreu një vit burg për vjedhje duke shpërdoruar detyrën në janar të 2016-ës. Por pasi u lirua, jeta e tij politike nuk ishte si më parë, ndërsa të gjithë jemi kuriozë se me çfarë po angazhohet aktualisht ish-ministri. Historiani Arben Llalla poston një foto të Kserës në Athinë. Sipas tij, ai po tenton të rihyjë sërish në politikë, por këtë herë jo në Shqipëri, por në Greqi. "Ku gjendet i dënuari për vjedhje të shtetit shqiptar ish-ministri, Spiro Ksera? Pasi bëri disa vite burg si hajdut, Spiro Ksera po qëndron në Janinë nën shoqërinë e kryetarit të prefekturës së Janinës Aleksandër Kahrmanis, i cili është vllah. Ksera po mundohet të riciklohet si politikan, por jo më në Shqipëri, por në Greqi. Fotoja është bërë më 31, tetor, 2017, Janinë", shkruan historiani.



Edi Rama shkon për inspektim në Fier, vishet me çitjane

Kryeministri i vendit, Edi Rama ka qenë dje, në Fier, për të parë nga afër përfundimin e një investimi për ujësjellësin e këtij qyteti. Bëhet fjalë për një investim të financuar nga gjermanët dhe BE-ja dhe të mbështetur nga qeveria shqiptare. Ajo që ka bërë përshtypje në këtë vizitë ka qenë edhe veshja që ka zgjedhur kryeministri. Ai është fotografuar i veshur me xhakëtë, këpucë serioze dhe me pantallona tip çitjanesh me ngjyrë të zezë. Kjo veshje nuk duhet të çudisë askënd, pasi nuk është hera e parë që Rama i vesh, por këtë herë ka lënë atletet dhe ka veshur çitjanet.



BULEVARDI

POLITIK



Na merrni seriozis!..!



Opinion *i* Ditës

Nga Zoje Jakaj

(Vijon nga faqja e parë)

... pas 5 viteve do kthehet në problem të madh social dhe do mbushet me kriminelë serialë.

Një nga problemet me të cilat përballet shoqëria, jo vetëm shqiptare, por edhe ajo globale janë mënyrat me të cilat ne përballemi me njerëzit devijantë, pra me njerëzit që kanë sjellje ndryshe, siç është rasti edhe i adoleshentëve e të rinjve të dhunshëm.

Në vendin tonë mungojnë shkollat e riedukimit dhe mënyra e vetme që të rinjtë e adoleshentët të vuajnë dënimin e tyre është burgu.

Si një për drejtuesve të një IEVP që shikoja shumë të rinj në burg, ku jo në pak raste të denoncuar edhe nga familjet e tyre për shkak të dhunës sistematike që i riu ose e reja ushtronte, e jeta e tyre familjare kthehej në makth, detyroheshin t'i denoncinin fëmijët e tyre me shpresë se një ditë do përmirësoheshin e do ndryshonin sjellje me prindërit. Por, a ndodh përmirësimi? Aspak, përkundrazi bëhen më keq dhe jeta tyre merr kah krejt tjetër. Jam përballur disa herë me prindërq që denoncinin fëmijët e tyre, sepse nuk ka shteti një shkollë riedukimi që këta të rinj problematikë t'i drejtojnë në këto dyer për t'u riedukuar dhe rehabilituar. Institucionet shtetërore përgjegjëse për edukimin social në këtë vend të formojnë dhe rregullojnë me ligj shkollat riedukimi.

"Dua t'i bëj një thirrje shtetit shqiptar për nevojën e këtyre shkollave të riedukimit, sepse ka mësues pafund në pritje të një punësi dhe ata do jenë shumë të dobishëm, nëse këto kapacitete shfrytëzohen në dobi të kësaj kategorie. Një i ri, një adoleshent që prek dyert e një burgu nuk rehabilitohet, por ndryshon përgjithnjë jeta e tij dhe nuk ka asnjë shans të integrohet në shoqëri pas traumës që përjeton në dyert e një burgu dhe kur del nga ato dyer në shoqëri, nuk i ofrohet asgjë. As punë, as jetë të rregullt dhe përsëri kthehet në recidivist. Përkundrazi, shpesh vetë elementet që janë shokët e tij të dhomës e ditës gjatë vuajtjes së dënimit e orientojnë të kthehet në vrasës me pagësë, apo hajdut i rëndomtë rruge ose profesionist për mbijetesë. Ka psikologë pa fund, të cilët kanë të mbaruar shkollat që kapacitet e tyre sociale e psikologjike të përdoren për të rehabilituar këta të rinj, që për një mijë e një arsye në këtë vend prekin dyert e një burgu dhe e kalojnë ditën në shoqëri të të rriturve, që kanë shumë eksperiencë negative për të ua inductuar lehtë të keqen. Sa nuk është vonë, shpëtoni të rinjtë shqiptarë, por kjo rregullohet vetëm me politika social-psikologjike të mirëmenaxhuara nga shteti, duke ngritur shkollat e riedukimit.

Po ju rrëfej një histori të dhimbshme si një drejtuese burgu.

Në vitin e parë të punës sime më vinin shumë letra nga të dënuarat. Isha e ndjeshme kryesisht ndaj



letrave të shkruara nga të rejtat, (unë njihem si një njeri me prirje të theksuara për të zgjidhur problemet e mëdha sociale, për shkak të punës që kisha bërë në vite si mësuese gjimnazesh dhe pedagoge universiteti me adoleshentë e të rinj). Në këndvështrimin tim këto kategori ishin të pambrojtura, shpesh nga jeta që bënin, varfëria në familje dhe pamundësia për shkollim më tepër se 9-vjeçarja e detyrueshme nga shteti dhe burgu për ta ishte destinacion i dhimbshëm në shumë pikëpamje.

Një nga letrat e javës që shqyrtova në grup ishte e një vajze të re 21-vjeçare, që më rrëfeu se mama ja e saj e ka denoncuar dhe e ka futur në burg vetëm për ta ndarë nga i dashuri. Më impresionoi si histori dhe mblodha sektorin e edukimit, të shëndetësisë dhe sektorin e policisë që të zbulonim të vërtetën në grup, pasi punët e dobishme në atë institucion funksiononin mirë nëse realizoheshin bashkërisht dhe duke u konsultuar me psikologun që ndjek rastin,

me mjeken për të parë problemet e shëndetit mendor dhe shafen e policisë për të kuptuar më thellë paraqet rrezik për sigurinë e personave të dhomës ose të grupit ku ajo kryen aktivitetin ditor. Vajza me inicialet A.K. ishte pa probleme të theksuara dhe ndodhej në parburgim, shpesh mbytej në lot dhe nuk e pranonte që të ketë abuzuar me të emën. Ishte vajzë me sedër dhe në konkluzionet që arritëm, ishte e rritur me vështirësi pasi i mungonte babai dhe punonte vetëm nëna. Kjo gjatë kohës që e ëma ishte në punë kishte braktisur shkollën dhe ndodhej në shoqëri problematike, që po e orientonte drejt rrugës së drogës e prostitucionit. Kërkuam takim me mamën e saj dhe arritëm pas disa përpjekjesh 6-mujore që të bindim nënën e vajzës me emrin A. të tërhiqte denoncimin dhe të pajtohej më të bijën. Arsyeja që ngrite nëna e A-së ishte dhuna që ushtronte vajza e saj në familje, sepse shoqërohej me një djalë narkoman dhe ai e detyronte në mënyre

sistematike t'i merrte para nënës së saj me apo pa pahir. Pas shumë e shumë takimesh të lodhshme, stresuese dhe problematike që bëme në grup me nënën e bijës, arritëm të bëjmë paqe mes tyre dhe ditën që i vinte e ëma në takim, ajo herë ishte e lumtur, herë e ngarkuar emocionalisht dhe grind-ej me mamën e saj.

Ditën që ajo fitoi lirinë më premtoi se do i rikthehej shkollës dhe jetës normale, e bëri apo jo, ne si institucion nuk e kishim për detyrë, por as mundësi financiare që ta ndiqnim rastin edhe jashtë dyerve të burgut, e për pasojë na rrëmbeu histori të tjera me po aq dhimbje e dramë. Ndaj, për t'u ardhur në ndihmë këtyre familjeve dhe të rinjve me probleme, detyrimisht duhen hapur shkollat riedukimi, që rasti nga fillimi deri në fund të përmirësohet e të zgjidhet në rrugë shtetërore përmes riedukimit dhe rehabilitimit, pikë e dobët e sistemit dhe e parregulluar akoma me ligj.

Autore librash, pedagoge

HOROSKOPI

DASHI

Do të jeni të suksesshëm në shkollë dhe në punë. Ndoshta në të vërtetë ndiheni të pakënaqur, por kur ke fantazi e tejkalon mërzi-tjen! Venusi plot gjallëri, gjatë ditës ju mbështet ëmbëlsisht ëndrrat dhe dëshirat, ndërsa në mbremje ju sjell me këmbë në tokë.

DEMI

Lërimi butësinë që të rrjedhë lirisht. Do të shërbejë për të çimentuar një lidhje të konsoliduar ose të shkrijë ndrojtjen në një marrëdhënie të porsalindur. Në punë do t'ju duhet të pranoni disa kompromise, solidariteti është i barasvlershëm me suksesin e ndërmarrjeve.

BINJAKET

Do të jeni me miq dashamirës dhe përkrahës, me të cilët do të vendosni të organizoni një shtëpitë të bukur. Mes artit dhe natyrës, bashkëpunoshi është edhe më e lehtë. Shpenzime të paparashkuara në punë, kompjuteri dhe printeri kanë nevojë për ndërrhyjen e një tekniku.

GAFORJA

Në dashuri do të tregoheni pak posesiv si edhe do të ndikoheni nga kritikat dhe pakënaqësitë në familje. Jeni të qetë vetëm miq, që të ju mundësojnë ekuilibër. Do të keni disa shpenzime të mëdha për shtëpinë, bëhet fjalë për punime mirëmbajtje.

LUANI

Do të mbizotërojë shpirti i skuadrës me kolegët, kur njeri nuk ia del e ndihmon tjetri, pa zili dhe kritika, për të arritur objektivin. Investimet do të duhet të monitorohen, konsultohuni me një ekspert të kësaj fushë. Do të bëni blerje interesante në librarë.

VIRGJERESHA

Në kontakt me publikun jeni gjithmonë të preferuar, buzëgëshja juaj lehtëson barrën dhe shkrin pakënaqësitë e atyre që janë në pritje. Do të kaloni një mbremje shumë të bukur dhe argëtuese në shtëpinë e miqve të juaj.

PESHORJA

Është dita ideale për ata që kanë dëshirë të bëjnë punime, në shtëpi keni me të vërtetë shumë punë për të bërë. Mjetet dhe materialet do të jenë të kushtueshme, por do t'ia vlejë. Edhe në zyrë atmosfera është e qetë, të gjithë mendojnë për punën e tyre pa ndërrhyrë në atë të tjerëve.

AKREPI

Do të keni krijimtari të rafinuar. Arti, fotografia dhe muzika nuk janë thjesht hobi, por mund të kthehen mundësi profesioni. Plan-etë bashkëveprojnë për t'ju mbështetur. Do të keni shumë energji, pasion dhe besim në aftësitë e juaj krijuese.

SHIGJETARI

Do jetë një ditë shumë e qetë dhe paqësore, e dobishme për ata që kanë punë të ngutshme për të bërë ose që duhet të bëjnë punime në shtëpi. Sot është i rëndësishëm edhe kontakti fizik. Me një ledhatim shprehni të gjithë thellësinë e ndjenjës.

BRICJAPI

Mërkuri miqësor në bashkëveprim me Neptunin, krijonë situatën ideale për të bërë paqe me partnerin, nëse do të ishte e nevojshme, dhe të t'i ktheni përsëri buzëgëshjen njëri-tjetrit. Ndërkaq, është thelbësore që të përballeni gjithmonë me të vërtetën.

UJORI

Hëna ju bën të ndiheni të sigurt. Do të shfaqni prova të mëdha të miqësisë dhe idesësh të përbashkëta me të njohurit. Do të tregoni gatishmëri drejt një kolegu, i cili po kalon nëpër një fazë të vështirë. E dini që vepra do t'ju shpërblehet.

PESHQIT

E keni mendjen e turbullt, mes fantazive të parrealizueshme dhe projekteve të cun-guara. Nëse kërkoni gjëra, dhe është mirë që e bëni, mbështetja nuk do t'ju mungojë. Ajo që mungon sot është në veçanti dëshira të hyrë në lojë, duke shfrytëzuar kapacitetet e juaja.

Prezantimi i tretë i "Bobit" në tre vjet. Ka veç mjaltë për Luçiano Moxhin e Iulianon

Starova: Kupa, objektivi ynë, dua mbështetjen e tifozëve

Zbutet për lojtarët, nuk janë më "surrogato"



Jeton Selimi

Sulejman Starova merr zyrarisht drejtimin e Partizanit për herë të tretë në epokën "Demi", ndërsa nga sot nis punën për të mbyllur hendekun me ekipet e kreut. Pas falënderimeve të rasit, Starova deklaroi se kampionati i Partizanit nis në këtë çast dhe kërkon mbështetjen e tifozëve të kuq në një moment të tillë të vështirë.

"Falënderoj presidentin dhe gjithë kryesinë e klubit që menduan që vazhdimësinë e punës të ma besojnë mua. Kjo është kënaqësi dhe respekt, por edhe një detyrim i madh, siç është legjenda e Partizanit. Fillojmë një kampionat me tri faza ditën e mërkurë. Objektivi është të grumbullojmë më tepër pikë se të gjithë, duke filluar nga Skënderbeu, që udhëheq me meritë kampionatin. Kemi tri ndeshje që duhet të grumbullojmë më shumë pikë se ata, po kështu me radhë Kukësi i vendit të dytë dhe të tjerët. Na duhet të jemi akoma më të bashkuar, i bëj thirrje dhe tifozërisë që nuk duhet të mërziten, ose të kalojë mërzitja sa më shpejt, në mënyrë që parulla që nuk e lënë skuadrën asnjëherë vetëm të bëhet realitet. Deri tani nuk ka munguar asgjë sa i përket përkrahjes gjatë 90 minutave, por lojtarët që të



japin maksimumin, duhet të kenë përkrahjen e tifozëve". Starova ka besim te grupi i lojtarëve, ndërsa sheh vetëm besimin reciprok rrugën e duhur për të dalë nga kriza. "I kemi të gjitha mundësitë që të realizojmë objektivin që iu thashë me këtë grup që kemi. Nuk ka gjë për të fshehur që skuadra do përfordhet në janar. Por në harkun e tri fazave duhet të jemi të durueshëm. Kthesa nuk bëhet në mënyrë rrënjësore. Kemi një kampionat me tri faza dhe duhet të marrim pikë më shumë se rivalët. Kjo do na ngjijtë lart në shkallët e tabelës dhe do na afrojë me ato objektiva madhore që ka

Partizani. Jam me besim te skuadra dhe skuadra dhe te vetja, kjo është rruga për t'u kthyer aty ku duhet". Me Skënderbeun që 'futuron' në krye të renditjes, Starova devijon objektivin e Partizanit te Kupa e Shqipërisë. "Kryesorja është Kupa, ndërsa tjetra nuk nxitoj të them, por duhet të fitojmë më shumë se kundërshtari këto tri faza, por nuk mund ta përcaktoj deri ku mund të shkojmë. Shpresojmë sa më lart në kampionat". Nuk mund të anashkalohej fakti se Starova dhe Moxhi patën fërkime një muaj më parë me akuzat publike të "Bobit" ndaj ish-drejtorit juventin, ndërsa

trajnerin Iuliano e cilësoi të paaftë. Gjithsesi, Starova duket se ka ndryshuar mendim. "Nuk më intereson se çfarë thonë të tjerët. Iuliano jam i bindur që është trajner i mirë. Nuk është i pari ai, të gjithë të huajt që vijnë në Shqipëri nuk kanë kohën e duhur për të njohur futbollin shqiptar. Kjo është arsyeja që ai nuk pati rezultatet e duhura. Skuadra është stërvitur mirë, me disiplinë, ndryshe nga zërat që thonë të kundërtën. Unë nuk vij nga jashtë, jam i klubit dhe nuk ka ndarje në grupe në skuadrat. Mungesa e rezultateve amplifikon shumë gjëra që nuk ekzistojnë. Kam fjalët më të mira për

Iulianon, por edhe për Moxhin, që ishte kryesori që më kishte mua kandidaturë të vetme. Nuk jemi të kënaqur nga afrimet që janë bërë, sepse vjet ishim de facto skuadra kampione, de jure jo, për arsye që i kam thënë 100 herë dhe tregërore i ekipit këtu ishin më të mirët vjet. Nuk i zëvendësuam në nivelin e duhur të larguarit. Tani të bëjmë më të mirën". Gjithashtu, Starovës do t'i duhet të punojë me lojtarë që ai i pat cilësuar "surrogato", por Starova nuk e prek këtë temë, ndërsa nxiton ta mbyllë konferencën për të filluar stërvitjen. "Doni që të them shumë gjëra, por nuk kam shumë kohë tani, sepse fillon stërvitja. Do i shohim rrugës ata lojtarë. Përgjigja dihet, kush vesh fanellën e Partizanit, ka për detyrë të stërvitet e të japë maksimumin. Kemi kampionat të ri pa fazën e parë, lojtarët ta harrojnë fazën e parë. Të bashkuar do e kalojmë këtë situatë në mënyrë urgjente". Ndeshjet e Starovës do të nisnin mesjavën e ardhshme në ndeshjen kundër Laçit, fakt i çuditshëm ky, pasi edhe në dy rastet e tjera, "Bobi" e ka nisur pikërisht ndaj kurbinasve, aventurën e tij në krye të stolit të kuq.

SHKARKIMET



5 trajnerë të larguar në vetëm një fazë, Kamza "macja e zezë"

5 "koka" trajnerësh në 9 javët e para të kampionatit. Ka mjaftuar faza e parë e Kategorisë Superiore që gjysma e teknikëve, të cilët nisën këtë sezon të merrnin valixhet për të lënë skuadrat respektive. Ka rezultuar i pamundur vazhdimi i aventurës për Stavri Nicën te Laçi, Armando Cungun te Vllaznia, dyshe Kurbejo-Fernandez te Luftëtari, Artan Banon te Lushnja, e së fundmi dhe Mark Iulianon te Partizani. 5 trajnerë të larguar në 9 javë në një kampionat me 10 skuadra është padyshim një statistikë që konfirmim se durimi është një virtut ende jo shumë popullore në Shqipëri, edhe pse nuk bëhet fjalë vetëm për trajnerë të shkarkuar, por edhe dorëheqje. Gjithçka e lidhur me rezultatin dhe konfirmimi vjen nga fakti se duke përfunduar Laçin, kanë rezistuar vetëm trajnerët, skuadrat e të cilëve renditen në 5-shen e parë të klasifikimit. Mund të ishin edhe më shumë, me Maganin që bëri prapaktëhehu pas dorëheqjes publike vetëm falë këmbënguljes së presidentit të Teutës, Hysenbelliu, ndërsa askush nuk mund të thotë se çfarë do të kishte ndodhur me Milinkoviç, në rast se do të kishte humbur në Vlorë me Flamurtarin. E kotë të bësh parashikime se cili nga trajnerët aktualë do të arrijë t'i festojë Krishtlindjet në detyrë, por mjaft interesant është fakti se nga 5 trajnerët e larguar, 3 prej tyre janë viktima, sigurisht në thonjëza të Kamzës. Kështu ishte humbja me skuadrën e ngjitur këtë vit në Superiore, që i vuri fjalën fund aventurës së teknikëve uruguaijanë te Luftëtari, sërisht një humbje me Kamzën rezultoi fatale për Armando Cungun, që pas asaj disfatë dha dorëheqjen nga drejtimi i Vllaznisë, ndërkohë që ishte sërisht Kamza që surprizoi me Partizanin duke 'derdhur kupën' për Mark Iulianon. Statistikë interesante ajo e skuadrës së Ramadan Ndreut, sfidën e radhës në kampionat e kanë me Kukësin, një motiv më shumë për Milinkoviç për t'i pasur frikë.

Ish-trajneri i Realit

Shuster: Kënaqësi kur shoh fytyrën e Ronaldos kur nuk shënon



Ish-trajneri i Realit të Madridit, Bernd Shuster po e shijon momentin negativ që po kalon Kristiano Ronaldo. Futbollisti portugez ka shënuar vetëm 1 gol në kampionatin spanjoll deri tani, teksa as në ndeshjen e fundit nuk arriti që të gjente rrugën e rrjetës. "Aktualisht po shënojnë mesfushorët, Kasemiro apo Isko, por do të kthehen golat e sulmuesve. E rëndësishme është që skuadra të fitojë, jo se kush shënon. Më e bukura është kur shoh fytyrën e Kristianos kur nuk bën gol. Sulmuesit duan golin, nuk mjaftohen me pasimet për gol apo kilometrat e përshkuara", tha Shuster në një intervistë për mediat

iberike. Më tej, ai foli edhe për momentin e vështirë që po kalojnë "galaktikët". "Realit tani është i lodhur. Ka luajtur dy Superkupa, kanë qenë ndeshjet e kom-

mbëtareve dhe periudha e dobët i rastisi tani. Mendoj se largimi i Moratës i bëri keq Realit dhe do e ndjejë mungesën e tij", deklaroi Bernd Shuster.

MOTO GP

Mark Markez: Kujdes, në Valencia titulli nuk është i sigurt!

21 pikë avantazh ndaj Andrea Dovizioso, kur ka zmbetur vetëm Çmimi i Madh i vitit në Moto GP. Mirëpo Mark Markez e ka të qartë se në pistën e Valencias mund të ndodhë gjithçka. "Do të ketë shumë presion dhe kjo është e natyrshme, sepse garohet për diçka të madhe. Sigurisht që nuk do të jetë e lehtë dhe ne nuk do të shkojmë në Valencia shumë të sigurt për titullin. Do të jetë e nevojshme që të kemi të njëjtin mentalitet dhe metodën e punës, që na kanë sjellë deri këtu ku jemi sot. Do të japim 100% për ta mbyllur në mënyrë më të mirë të mundshme". Piloti i Repsol Hondas është i bindur se pista e Valencias e favorizon, pasi i përshatet më shumë. Të jem i sinqertë, kemi qenë në presion përgjatë gjithë pjesës së dytë të sezonit. Fakti që kemi mundur të reagojmë si duhet në disa momente të vështira, siç ndodhi edhe në Malajzi, më jep ndjesi shumë pozitive para garës së Valencias. Kjo pistë u përshatet karakteristikave të mia. Do të jetë e rëndësishme që ta nisim fort që në sesionin e parë të provave të lira".



www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

